**VENDIM**
**Nr. 419, datë 27.5.2020**

## PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT SHTETËROR PËR MBËSHTETJE NË FUQIZIM DHE ANGAZHIM TË DIASPORËS SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 16/2018, "Për Diasporën", dhe të nenit 11, të ligjit nr. 115/2017, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës", me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e programit shtetëror për mbështetje në fuqizim dhe angazhim të Diasporës shqiptare, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

MBËSHTETJE PËR FUQIZIMIN DHE ANGAZHIMIN E DIASPORËS SHQIPTARE
2020–2024
(PROJEKT)
MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN

**Migracioni në kohët që jetojmë nuk është sasi, por cilësi.**

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit dhe e Integrimit dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, synojnë të sigurojnë migrim të sigurt dhe të rregullt, të kufizojnë shfrytëzimin dhe abuzimin e migrantëve, të zvogëlojnë kostot e rekrutimit dhe të dërgesave monetare dhe të nxisin angazhimin e Diasporës në procesin e zhvillimit të vendlindjes.

Dokumenti i Programit për mbështetje në fuqizim dhe angazhim të Diasporës shqiptare, është një projekt në mbështetje të Strategjisë Kombëtare të Diasporës Shqiptare. Ai po është konsultuar me agjencitë e bashkëpunimit teknik dhe organizatat joqeveritare.

Shqipëria ka njohur nevojën për të angazhuar Diasporën, duke ndërtuar një mjedis të përshtatshëm për kontributet e saj. Ky angazhim vlerëson krijimin e lidhjeve ekonomike dhe sociale, përshpejtimin e reformave strukturore për këtë qëllim. Dokumenti është një pamje përgjegjësisë shtetërore të Shqipërisë për lidhjet e organizuara me Diasporën shqiptare, të përcaktuara nga qëllimet e përbashkëta. Ai do të kërkojë bashkëpunimin e agjencive dhe donatorëve të interesuar.

Çdo bashkëpunim dhe kontribut si një kanal komunikimi i cili ndihmon në përmirësimin e programit dhe bashkëpunimin e donatorëve për aplikimin ndërsektorial ka nevojë për konsultime. Qëllimi është angazhimi i Diasporës shqiptare në vendlindje, si një mënyrë e re veprimi në zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të Shqipërisë.

Ai synon vlerësimin e migracionit në një mundësi zhvillimi, e cila do të kurojë arsyet e largimit nga vendlindja. Pasoja do të ndryshojë shkakun.

Ju faleminderit!

Pandeli Majko

Partner Zbatues:
Pala Përgjegjëse:

**Përmbledhje e shkurtër**

Kapitali i vlefshëm intelektual dhe kontributet e tjetra të mundshme nga Diaspora, që mund të japin një dorë për të përballuar sfidat e vendit ose për të promovuar Shqipërinë anembanë globit, mbeten ende të pashfrytëzuara. Parë nga ky këndvështrim, qëllimi i përgjithshëm i Programit është të zgjerojë mundësitë socio-ekonomike dhe perspektivat për gratë dhe burrat në Shqipëri, si dhe të përmirësojë jetesën e tyre duke rritur nivelin e angazhimit të Diasporës. Kjo do të arrihet duke përmbushur tri rezultate specifike:

1. Ministri i Shtetit për Diasporën (MSHD) në bashkëpunim me institucionet qeveritare të niveleve të ndryshme, përdor dhe zhvillon më tej instrumentet për t'u lidhur, shkëmbyer dhe angazhuar në mënyrë aktive me anëtarët dhe organizatat e Diasporës.
2. Bashkitë harmonizojnë strategjitë e zhvillimit me Strategjinë e Diasporës Shqiptare; ofrojnë shërbime më të mira dhe më të shumta në numër për anëtarët e Diasporës, dhe nxisin iniciativat e komunitetit për të tërhequr njohuritë dhe investimet e Diasporës.
3. Partnerët e Diasporës transferojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre dhe bëjnë investime të përbashkëta me sektorin privat në Shqipëri, duke krijuar kështu vende të reja pune.

Ky program është hartuar me iniciativën e ministrit të Shtetit për Diasporën.

**Lidhja me OZHQ-të: 8, 9, 10**
**Lidhja me agjendën e anëtarësimit në BE:** kontributi i tërthortë në kapitullin 20 "Ndërmarrjet dhe politikat industriale"

**Lidhja me SKZHI-në**: qeverisje gjithëpërfshirëse dhe demokratike dhe rrugët e zhvillimit të qëndrueshëm

| | | |
|---|---|---|
| **Burimet totale të nevojshme:** | | |
| **Burimet totale të alokuara:** | | |
| | | |
| | | |
| **Të pafinancuara:** | | |

**… Asgjë për ne, pa ne….**
Motoja e Grupit të Anëtarësimit në G7+ OBT

Tabela e përmbajtjes

1. Analiza e situatës
1.1 Konteksti kombëtar dhe ndërkombëtar
1.2 Analiza sektoriale dhe socio-ekonomike
1.3 Kuadri strategjik i qeverisë
1.4 Sfidat
2. Komponentët e programit
2.1 Vizioni dhe objektivat e programit
2.2 Komponenti I
2.3 Komponenti II
2.4 Komponenti III
3. Kuadri i menaxhimit
3.1 Menaxhimi dhe koordinimi
3.2 Monitorimi dhe vlerësimi
3.3 Rreziqet dhe masat lehtësuese
4. Kuadri ligjor
5. Buxheti tregues dhe strategjia për mobilizimin e burimeve
5.1 Buxheti

5.2 Plani i mobilizimit të burimeve
Shtojcë I. Lista paraprake e fishave të projektit

**1. Analiza e situatës**
**1.1 Konteksti kombëtar dhe ndërkombëtar**

Në shumicën e rasteve, pavarësisht se largohen nga vendi, emigrantët ruajnë lidhje të forta emocionale, financiare dhe familjare me Shqipërinë. Njëkohësisht, komunitetet shqiptare në Diasporë, përgjithësisht, janë të integruara mirë dhe në kushte më të mira në vendet pritëse, krahasuar me komunitetet e emigrantëve në vitet e para '90-s, dhe kanë potencialin dhe entuziazmin për të kontribuar në zhvillimin e vendlindjes. Megjithatë, me gjeneratat e reja, lidhjet dhe ndjenja e përkatësisë së anëtarëve të Diasporës me vendlindjen sa vjen e dobësohet.

Pavarësisht mjedisit institucional të sapokrijuar, politikave të miratuara dhe kuadrit ligjor, ndërveprimi ndërmjet institucioneve shtetërore dhe komuniteteve shqiptare të Diasporës mbetet sporadik dhe ende i pastrukturuar. Diaspora nuk përfshihet ose konsultohet në mënyrë sistematike gjatë hartimit të politikave ose proceseve të vendimmarrjes, prandaj, kapitali i vlefshëm intelektual i Diasporës, i cili mund të ndihmojë për t'i bërë ballë sfidave të vendit dhe të promovojë Shqipërinë anembanë botës, mbetet ende kryesisht i pashfrytëzuar. Është e domosdoshme të vendosen kanale të dyanshme komunikimi dhe të ndërtohen lidhje më të forta për të nxitur lidhjen e Diasporës dhe forcimin e besimit ndaj institucioneve të vendlindjes. Mjete të shumta informacioni dhe komunikimi janë tashmë të disponueshme, si: kompjuterët, interneti, televizioni, radioja, mediet sociale etj. Këto janë mjete kyçe me anë të të cilave institucionet mund t'i japin Diasporës mundësinë të angazhohet për zhvillimin e vendit. Gjithsesi, përvoja e vendeve të tjera ka treguar nevojën për komunikim të strukturuar nga ana e qeverisë dhe qasje ndërlidhëse bazuar në hartëzimin e plotë të Diasporës.

Në botë ka 250 milionë imigrantë të gjeneratës së parë, që përfaqësojnë rreth 3% të popullsisë botërore. Diaspora, e cilat përfshin gjithashtu gjeneratën e dytë dhe të tretë, përbën një numër edhe më të madh, edhe pse është e vështirë për ta regjistruar në statistikat e imigrimit. Migrimi nga Jugu në Jug përbën rreth 36% të numrit të përgjithshëm të emigrantëve, përqindje e cila është afërsisht e njëjtë me lëvizjet nga Jugu në Veri. Është përllogaritur se më shumë se 400 institucione në 56 vende të ndryshme kanë angazhuar Diasporën nëpërmjet programeve ose strukturave të institucionalizuara[1], nga të cilat rreth një e treta ka filluar të miratojë politika për angazhimin e Diasporës vetëm pesë vitet e fundit.

Pavarësisht se institucionet po ndërgjegjësohen gjithnjë e më shumë për rëndësinë e angazhimit të Diasporës, kuadrit strategjik në zhvillim e sipër dhe përvojave të suksesshme që synojnë përfshirjen e Diasporës në proceset e zhvillimit, ka ende shumë rrugë për t'u bërë. Politika për një angazhim gjithëpërfshirës të Diasporës, e zhvilluar me nismën dhe e miratuar nga ministri i Shtetit për Diasporën [MSHD], përcakton një vizion të qartë, prioritetet dhe masat për t'u lidhur dhe angazhuar me Diasporën në zhvillimin e vendlindjes. Ajo synon gjithashtu të përcaktojë një udhëzues që tregon mënyrën si synon të angazhohet vendi me Diasporën. Politikat përshkruajnë çështjet që duhen trajtuar, qëllimet dhe prioritetet strategjike, palët e interesuara, zonat e programeve/ndërhyrjeve, strukturat institucionale, proceset konsultative etj., duke përcaktuar kështu një kundër më të gjerë për angazhimin e Diasporës. Për më tepër, ndër prioritetet e tjera, Strategjia e Diasporës përqendrohet edhe në forcimin e kuadrit institucional dhe të politikave me qëllim që të bëjë lidhjen mes migracionit dhe zhvillimit.

Duke pasur parasysh reformën dhe riorganizimin e fundit të situatës administrative dhe territoriale të vendit si dhe ndryshimet e fundit në ligjin për qeverisjen lokale, që shton

---

[1] Përllogaritur si pjesë e një studimi të shteteve që marrin pjesë në Forumin Global për Migrimin dhe Zhvillimin (GFMD) për manualin MPI dhe IOM (2012): Hartimi i një harte mënyrash për angazhimin e Diasporave në zhvillimin e vendlindjes. Një manual për hartuesit e politikave dhe praktikuesit në vend dhe në vendet pritëse, të disponueshme në: http://www.migrationpolicy.org/pubs/thediasporahandbook.pdf (parë për herë të fundit më 26.8.2013).

kompetencat e njësive të qeverisjes vendore lidhur me angazhimin e Diasporës dhe migracionin, ekziston nevoja për një koordinim ndërinstitucional dhe një qasje tërësore të qeverisë. Në vitin 2017, ministrit të Shtetit për Diasporën (MSHD) iu caktua përgjegjësia për të udhëhequr ndërveprimet me Diasporën, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet e tjera përkatëse. Ndërkohë që përkatësia dhe kapaciteti i administratës dhe strukturat në varësi të MSHD-së kanë qenë në rritje, qeverisja vendore përballet me mungesa fondesh dhe strukturash të përshtatshme për të t'ia bashkangjitur administratës përgjegjësinë për çështjet e Diasporës, si dhe me mungesa në mjetet dhe njohuri themelore për të përfshirë Diasporën në mënyrë aktive në zhvillimin vendor. Nën drejtimin e MSHD-së janë bërë disa përpjekje për të pilotuar integrimin e çështjeve të migracionit dhe politikat e Diasporës në kuadrot strategjike në sektorë dhe nivele të ndryshme të qeverisjes.

Shërbimet publike që lidhen me Diasporën (si p.sh.: lëshimi i dokumenteve, regjistrimet, licencat, pagimi i taksave, shërbime informacione etj.) janë shumë të kufizuara dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjen e Diasporës, gjë që do të siguronte disponueshmëri më të lartë për ta dhe uljen e kufizimeve për shkak të distancës. Përpjekjet e bëra deri më tani duhet të forcohen nga një qasje proaktive, e besueshme dhe e bashkërenduar e informacionit publik dhe e komunikimit me Diasporën, e drejtuar nga MSHD-ja dhe me përfshirjen e institucioneve të tjera shtetërore. Megjithëse nuk ka të dhëna gjithëpërfshirëse për sa i përket nivelit arsimor të Diasporës. Të dhënat e pjesshme tregojnë se ekziston një potencial i konsiderueshëm për sa i përket kapitalit njerëzor dhe transferimit të njohurive. Për më tepër, Diaspora shkencore është e interesuar të kontribuojë, duke besuar se ajo mund të ndikojë pozitivisht në përparimin e vendit. Sidoqoftë, pavarësisht nismave të institucioneve, ende mungojnë individët dhe organizatat në Diasporë, si dhe mekanizmat e qëndrueshëm për transferimin e njohurive nga Diaspora, me qëllim zhvillimin e Shqipërisë.

Angazhimi i Diasporës në zhvillimin e brendshëm kërkon përpjekje të bashkërenduara nga një sërë palësh të interesuara institucionale, joqeveritare dhe të sektorit privat, të cilët mund të nxisin ose të frenojnë ndryshimet pozitive. Përmbledhja më poshtë paraqet palët e interesuara me ndikim që mund ta çojnë përpara procesin, si dhe ata që kanë potencialin për të penguar atë.

Ministri i Shtetit për Diasporën [MSHD] është ndër palët kryesore institucionale, që i është dhënë mandati me përgjegjësinë për të drejtuar ndërveprimin me Diasporën, dhe së bashku me të gjithë institucionet homologe, për të nxitur zhvillimin e politikave, strategjive dhe shërbimeve përkatëse. MSHD-ja është palë e angazhuar seriozisht, e cila ka forcën shtytëse në këtë fushë. Ky rol mund të përforcohet më tej duke rritur kapacitetin e burimeve njerëzore dhe organizative, si dhe pozicionimin e tij si institucioni parësor që drejton politikat, strategjitë dhe koordinimin në vend për angazhimin e Diasporës. Gjithashtu, MSHD-ja gëzon mundësinë e rëndësishme për të nxitur angazhimin e politikave për veprim në këtë fushë. Përveç MSHD-së, ministritë e linjës vazhdojnë luajnë një rol kyç, veçanërisht në aspektin e hartimit dhe zbatimit të Politikave, Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Diasporën, krijimin e një mjedisi nxitës për angazhimin dhe kontributin e Diasporës në zhvillimin e vendit. Duke pasur këtë parasysh, Programi do të përdorë një qasje fleksibël zbatimi dhe partneriteti, duke iu referuar gjithashtu angazhimit të përgjithshëm politik të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Ai, gjithashtu, do të angazhojë në mënyrë aktive në punën e tij të gjitha nivelet e qeverisjes, duke përfshirë hartimin dhe dorëzimin e politikave, strategjive dhe masave që lidhen me Diasporën, duke respektuar plotësisht mandatet dhe përgjegjësitë e tyre, dhe duke u përqendruar në veprime të orientuara drejt rezultateve, që demonstrojnë potencialin e angazhimit të Diasporës në zhvillimin e vendit, përtej aspekteve politike.

Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjithësisht të përkushtuara dhe lojtarë kryesorë, të etur për të përmirësuar bashkëveprimin dhe lidhjen e tyre me Diasporën, si edhe të korrin frytin e përfitimeve nga kontributi i Diasporës në zhvillimin vendor. Prandaj, njësitë e qeverisjes vendore shihen si nxitës kryesorë të ndryshimit, gjithashtu, edhe për faktin se lidhja në nivel vendor bazohet më tepër në lidhjet të forta me qytetet e lindjes. Këshillat e qarqeve janë gjithashtu palë të

interesuara sidomos në përmirësimin e bashkëpunimit me Diasporën, duke ndërtuar mbi përpjekjet në lidhje me integrimin e migracionit në strategjitë e zhvillimit rajonal. Përfshirja e tyre në Program do të jetë e kufizuar si pjesë e mbështetjes për zhvillimin e kapaciteteve që synojnë njësitë e qeverisjes vendore, si dhe duke eksploruar mundësitë për një bashkëpunim të decentralizuar ose territorial, me qëllim angazhimin e Diasporës.

Anëtarët e Diasporës në mbarë botën konsiderohen gjithashtu si forcë lëvizëse, duke marrë parasysh që kushtet e përgjithshme nxitëse janë vendosur nga qeveritë shqiptare, si dhe ndryshimin që ka pësuar retorika dhe perceptimi i përgjithshëm nga njerëzit dhe institucionet në Shqipëri për rolin dhe kontributin e Diasporës. Potenciali shtytës i Diasporës mund të dalë në pah vetëm nëse ekzistojnë mekanizma të përshtatshëm angazhimi, dhe nëse organizatat dhe organet e tyre përfaqësuese fuqizohen për t'u bërë pjesë e një marrëdhënieje të besueshme ndërmjet Diasporës, institucioneve dhe publikut të gjerë në vend.

Përveç kësaj, ambasadat dhe konsullatat e Shqipërisë në vendet e përzgjedhura pritëse do të kenë një rol të rëndësishëm në procesin e konsolidimit, themelimit dhe forcimit të organeve përfaqësuese të Diasporës, duke mbështetur gjithashtu hartëzimin e Diasporës dhe nxitjen e mundësive të transferimit të njohurive të saj.

Organizatat dhe shoqatat e Diasporës përfaqësojnë zërin e anëtarëve të Diasporës në vendet pritëse dhe mund të luajnë një rol të rëndësishëm në proceset strategjike vendimmarrëse në Shqipëri, si dhe mund të nxisin nisma të çmuara për bashkëveprimin shoqëror, ekonomik dhe intelektual ndërmjet Diasporës dhe Shqipërisë. Në përgjithësi ata kanë lidhje të ngushta me vendlindjen, por angazhimi i tyre deri më tani është përqendruar kryesisht në aktivitete kulturore, arsimore dhe humanitare. Sidoqoftë, organizatat e Diasporës po përqendrohen gjithnjë e më shumë në potencialet e zhvillimit ekonomik. Për më tepër, ata shpesh përballen me sfida sa i përket organizimit dhe përfaqësimit, si dhe kapaciteteve të tyre. Kështu që, për të luajtur në mënyrë të efektshme rolin e një faktori lidhës në plan afatgjatë, organizatat e Diasporës duhet të konsolidohen dhe forcohen më tej. Në këtë proces, organizatat e Diasporës duhet të shohin gjithashtu një qasje të vërtetë dhe të besueshme nga institucionet në Shqipëri, që do të kontribuonte gjithashtu për krijimin e besimit dhe do të motivonte veprimtaritë e mëtejshme, të cilat shpesh bazohen plotësisht në angazhime vullnetare për të mbështetur vendlindjen.

Sektori privat në Shqipëri (duke përfshirë bizneset, organizatat dhe rrjetet e tyre) konsiderohet gjithashtu një nxitës i fortë i ndryshimeve. Bizneset e pranojnë potencialin e Diasporës në lidhje zgjerimin e sipërmarrjes dhe zhvillimin e biznesit. Nuk mungojnë as shembujt që ilustrojnë kontributin e Diasporës për zhvillimin e sektorit privat në Shqipëri përmes transferimit të njohurive, nxitjes së eksporteve dhe investimeve (siç është, për shembull, në sektorin e TIK-ut, turizmit, ose industrive të orientuara nga eksporti). Prandaj, forcimi i ndërveprimit me bizneset e Diasporës përmes lehtësimeve më të besueshme nga Dhoma e Biznesit të Diasporës dhe institucione në të gjitha nivelet e qeverisjes mund të nxjerrin më tej në pah potencialin e sektorit privat për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe hapjen e vendeve të punës. Në këtë kontekst, rol të rëndësishëm duhet të luajnë të gjithë institucionet dhe organizatat që mbështesin zhvillimin ekonomik në Shqipëri, si: dhomat e tregtisë, agjencitë e nxitjes së investimeve, agjencitë e zhvillimit lokal dhe rajonal, parqet teknologjike dhe nxitësit e biznesit. Ato kanë qenë gjithnjë e më aktivë dhe do të jenë çelësi për shkëmbimin ndërmjet bizneseve të Diasporës dhe shoqërive vendëse, si dhe për mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe nismave të punësimit. Duke pasur parasysh natyrën e tyre, interesin profesional, njohuritë dhe përvojat e akumuluara në zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e investimeve, ato konsiderohen si nxitës të fortë të ndryshimit.

Media mund të luajë një rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin e publikut për potencialin që ka Diaspora për të kontribuar në zhvillimin e vendit. Ato, gjithashtu, janë një kanal i fuqishëm për afrimin në shkallë më të gjerë të qeverisë me Diasporën, duke kontribuar potencialisht në lidhje më të forta midis Diasporës dhe Shqipërisë.

**1.2 Analizat socio-ekonomike**

Rritja e programeve dhe e institucioneve të Diasporës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit për flukset e remitancave, të cilat në vitin 2015 u përllogaritën në mbi 601 miliardë dollarë, shumica e të cilave ishin të drejtuara drejt vendeve në zhvillim[2]. Kërkimet tregojnë se remitancat ofrojnë ndihmë të menjëhershme për të varfrit, sidomos në kohën e krizave ekonomike dhe zhvendosen nga konsumi drejt financimit të kapital për sipërmarrjet. Duke pasur parasysh mënyrat e ndryshme për të dërguar remitanca, përmes bankave tregtare, operatorëve të transfertave të parave, transferimeve të parave nëpërmjet celularit, zyrave postare ose përmes kanaleve jozyrtare, dhe mënyrës së raportimit të remitancave nga një vend në tjetrin, është bërë gjithnjë e më e vështirë të përllogaritet shuma totale që shkon për investime. Pavarësisht këtyre paqartësive, ka mjaft prova empirike që tregojnë se ekzistojnë investime të konsiderueshme të kryera falë këtyre remitancave nga Diaspora.

Përtej rolit të tyre si dërgues të remitancave, Diaspora gjithashtu mund të promovojë tregtinë dhe investimet e huaja të drejtpërdrejta, të krijojë biznese dhe të nxisë sipërmarrjen, pasi shumica e emigrantëve, përveç se janë të mirarsimuar, janë edhe ekonomikisht aktivë. Niveli i ulët i investimeve dhe pjesëmarrja në ekonominë e Shqipërisë është si pasojë e besimit të ulët tek institucionet vendëse, mungesës apo dobësisë së organizatave të biznesit të Diasporës në vendet pritëse me potencial të lartë shkëmbimi ekonomik, si dhe të mjedisit jo të favorshëm të biznesit dhe kontakteve jo të forta ndërmjet bizneseve dhe ndërmarrjeve të Diasporës me ato në Shqipëri.

Nga ana tjetër, është inkurajuese fakti se Diaspora është e gatshme të marrë nismën ose të zgjerojë investimet në Shqipëri, kryesisht në qytetet e tyre të lindjes. Megjithatë, potenciali i tyre në lidhje me nxitjen e konkurrueshmërisë dhe rritjen e tregut të shoqërive shqiptare mbetet ende për t'u eksploruar, veçanërisht nëpërmjet lehtësimit të synuar të marrëdhënieve midis bizneseve, përfshirë këtu edhe nga qeverisja vendore. MSHD-ja përmes Dhomës së Biznesit të Diasporës, të sapokrijuar, së bashku me homologët e tyre në sektorin privat, duhet të identifikojnë mundësitë ekonomike, të përmirësojnë kornizat administrative, të mbështesin mentorimin, si dhe të ofrojnë stimuj për të ndërmjetësuar investimet nga Diaspora. Sa u përket të rinjve nga Diaspora, ata gjithashtu shfaqin interes për të kontribuar në zhvillimin e vendlindjes së tyre përmes pjesëmarrjes në tregun e punës, hapjes së bizneseve, dërgimit të remitancave, vendosjes së lidhjeve të biznesit me shoqëri në Shqipëri, si dhe ofrimin e këshillimeve pa pagesë për bashkëmoshatarët dhe shoqëritë e tyre në vendlindje.

Një numër i konsiderueshëm mësimesh dhe përvojash të përftuara nga praktika të ngjashme në këtë fushë, ofrojnë baza të shëndosha për formulimin e një programi më të të përshtatshëm dhe efektiv.

– Strategjitë e zhvillimit lokal me fokus Diasporën dhe strukturat e koordinimit të Diasporës nxisin nisma lokale efektive që përfshijnë Diasporën: kuadri strategjik i qeverisjes vendore me fokus Diasporën mundëson jo vetëm një punë më sistematike në këtë fushë, por edhe një gamë të gjerë praktikash konkrete me kontribut të prekshëm në zhvillimin lokal. Duke ndërmarrë veprime që përmirësojnë lidhjen me Diasporën, duke ofruar shërbime administrative dhe informative të përshtatura për Diasporën, si dhe masa të tjera që rigjallërojnë ndërveprimet e biznesit, kulturore, intelektuale dhe shoqërore, njësitë e qeverisjes vendore jo vetëm që lidhen me Diasporën, por gjithashtu rrisin kontributin e tyre të vlefshëm në zhvillimin lokal. Një rrjet i koordinatorëve të qeverisjes vendore i Diasporës mund të ndërtojë bazën për një rrjetëzim tematik të mundshëm më të gjerë, që do të bashkonte shqiptarët dhe do të mundësonte shkëmbimin e ideve dhe praktikave. Të gjitha këto elemente mund të zgjerohen më tej, duke mundësuar kështu një lidhje më sistematike të politikave të angazhimit të Diasporës, strukturave administrative dhe njohurive në nivel vendor.

[2] Martinez, C., Cummings, M. E., & Vaaler, P. M. (2015). Informaliteti ekonomik dhe ndikimi i financimit të sipërmarrjeve nga remitancat e emigrantëve në vendet në zhvillim. Revista e Sipërmarrjeve të Biznesit, 30(4), 526-545.

– Kapacitetet institucionale për t'u angazhuar me Diasporën në të gjitha nivelet e qeverisjes në vend janë të pamjaftueshme: të gjitha nivelet e qeverisjes mund të bëjnë më shumë për të hequr pengesat dhe për të krijuar mundësi që Diaspora të përfshihet në zhvillimin e vendit duke përmirësuar kuadrin strategjik përkatës; duke ndërtuar marrëdhënie të forta me rrjetet e Diasporës dhe duke lehtësuar përfshirjen e tyre në zhvillimin e vendit; duke stimuluar te Diaspora ndjenjën e përkatësisë dhe lidhjes me Shqipërinë, si dhe duke nxitur transferimin e njohurive. Për ta arritur këtë, institucionet dhe pikat e tyre të kontaktit duhet të jenë të kenë kuptim të qartë dhe njohuri më të mira mbi këtë çështje.

– Angazhimi i Diasporës është një urë e përbashkët: shkalla në të cilën Diaspora mund të ketë rol efektiv në zhvillimin e vendit varet nga gatishmëria, mundësia dhe kapaciteti i tyre. Disa anëtarë të Diasporës mund të "kthejnë" kontribute në vendlindje thjesht për arsye sentimentale, pa kërkuar shumë në këmbim. Megjithatë, përvoja botërore tregon se politikat e Diasporës funksionojnë më mirë kur angazhimi është si një urë e përbashkët, në të cilën të gjitha palët shohin përfitime të qarta nga puna e përbashkët. Prandaj, krijimi i besimit është i domosdoshëm për një marrëdhënie më të fortë Shqipëri–Diasporë.

– Nevoja për të njohur Diasporën: në mënyrë që të arrijë t'i drejtohet Diasporës, qeveria në të gjitha nivelet e saj duhet të njohë komunitetet e Diasporës në të gjithë botën. Kjo nënkupton mbledhjen sistematike dhe gjithëpërfshirëse të të dhënave dhe hartëzimin e Diasporës; hartimin e bazës së të dhënave mbi aftësitë dhe përvojat e Diasporës; dhe përfshirjen e një game të gjerë të anëtarëve të Diasporës në praktika konsultimi për të kuptuar se çfarë ofron Diaspora, çfarë është e gatshme të ofrojë, dhe çfarë pritet në këmbim nga qeveria.

– Diaspora zotëron një potencial të madh për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit: një nga mësimet kryesore të përftuara nga praktikat e ngjashme në të gjithë botën është se Diaspora mund të kontribuojë në krijimin e vendeve të punës dhe në përmirësimin e jetesës në nivel vendor. Përvojat e mëparshme zbulojnë gjithashtu potenciale të pashfrytëzuara për sa i përket lidhjes së kapitalit ekonomik dhe njohurive të Diasporës me mundësitë ekonomike dhe zhvillimin ekonomik. Në mënyrë që këto përpjekje të rezultojnë të suksesshme, nevojitet një qasje më e fortë e mirë informuar dhe e drejtpërdrejtë, si nga nivelet e qeverisjes vendore ashtu edhe nga institucionet e larta qeverisëse, ashtu edhe nga organizatat e biznesit të Diasporës, Dhoma e Tregtisë së Diasporës dhe organizata të tjera mbështetëse për zhvillimin ekonomik në Shqipëri.

– Nevoja për asistencë afatgjatë zhvillimi për ndryshime transformuese: përvojat nga ndërhyrjet e mëparshme konfirmojnë se ndërhyrjet në ndryshim të sistemit dhe mentalitetit kanë nevojë për më shumë se një dekadë që të integrohen me sukses, sidomos kur këto ndryshime zbatohen në një kontekst paqëndrueshmërie financiare dhe politike. Prandaj, për të nxitur interes të mjaftueshëm, duhet krijuar një nivel bazik njohurish dhe i strukturave në të gjithë sistemin e qeverisjes, si edhe duhen hartuar dhe ofruar politika dhe strategji me fokus Diasporën, duke kultivuar kësisoj një bashkëveprim produktiv dhe besim të ndërsjellë mes Diasporës, qeverive dhe bizneseve të cilat pastaj përkthehen në rezultate të zhvillimit. Kësaj lloj ndërhyrjeje i duhet një periudhë kohore afatgjatë, e cila tejkalon jetëgjatësinë e këtij Programi.

– Ndërlidhje e pamjaftueshme me rrjetet dhe përvojat përkatëse globale Programi do të përqendrohet kryesisht në përvojat dhe praktikat më të mira të programeve të ngjashme mbi integrimin e migracionit në planifikimin e zhvillimit të zbatuar kryesisht nga KB-ja dhe IOM-i9, veçanërisht në procesin e hartimit të politikës së Diasporës dhe zhvillimit të kapaciteteve institucionale në përfshirjen e Diasporës.

Me gjithë këta hapa të planifikuar në mendje, krijohen premisat e duhura për të avancuar më tej me praktikat e suksesshme dhe vizionin bazë të politikave, dhe vijimësinë e punës për përmirësimin e kornizave strategjike dhe praktike që mundësojnë kontributin efektiv të Diasporës në zhvillimin e vendit.

**1.3 Kuadri strategjik i qeverisë**

Duke kuptuar zhvillimin dhe linjën e integrimeve evropiane, përfshirë angazhimin e Diasporës, kryesisht si një koncept të orientuar drejt zhvillimit, Programi ka një rëndësi të veçantë për nevojat aktuale strategjike të Shqipërisë, veçanërisht ato që lidhen me trajtimin e papunësisë dhe nxitjen e rritjes ekonomike. Për këto arsye, Programi do të kontribuojë në përmbushjen e qëllimeve strategjike të përcaktuara nga Strategjia e Diasporës, si dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim posaçërisht në drejtim të rritjes ekonomike dhe kohezionit social.

Gjithashtu, duke synuar adresimin ndaj kapaciteteve të qeverive lokale dhe masave të politikave, Programi do të mbështesë drejtpërdrejt zbatimin e përparësive strategjike të përcaktuara në strategjitë e zhvillimit lokal, veçanërisht ato që lidhen me shfrytëzimin e potencialit të Diasporës për zhvillimit të vendit.

Më tej, Programi është i rëndësishëm për Strategjinë e Evropës Juglindore 2020, si dhe Agjendën 2030 të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe kontribuon në arritjen e OZHQ 8 "Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë", OZHQ 9 "Ndërtimi i infrastrukturës rezistente nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e novacionit" dhe OZHQ 10 "Zvogëlimi i pabarazisë brenda çdo vendi dhe ndërmjet shteteve" ndërhyrja kontribuon në kapitullin 20 të negociatave të anëtarësimin në BE "Politika Industriale dhe Ndërmarrjet" nga pikëpamja e rritjes së konkurrencës së sektorit privat, inkurajimit të një mjedisi të favorshëm të biznesit, si dhe lehtësimin e investimeve të huaja.

**1.4. Sfidat**

Aktualisht Diaspora ka një aftësi në rritje të organizimit të saj në rrjete që mund të jenë me rëndësi strategjike në arenën e zhvillimit. Sipas një vlerësimi paraprak, ekzistojnë një numër i madh organizatash, shoqatash, me fokus veprimtari arsimore, kulturore, shkencore, afariste, sportive dhe fetare, ose rrjete të Diasporës në njëzet vende të vlerësuara në të gjithë botën. Midis këtyre organizatave, ka edhe shoqata të shumta të Diasporës nga vendlindja/rajoni, me një lidhje të fortë me vendin e origjinës. Në shumë raste, organizatat e Diasporës në vendet pritëse janë të ndara në grupe të ndryshme. Shoqatat, organizatat, grupet lokale dhe rrjetet e krijuara nga Diaspora shqiptare në të gjithë botën, janë relativisht të dobëta, joformale dhe të shkëputura nga bizneset, nga jeta arsimore, kulturore, shkencore, sportive dhe fetare në Shqipëri. Në veçanti, nevojiten më shumë përpjekje për të forcuar kapacitetet dhe për të mobilizuar organizatat e biznesit në Diasporë, t'i pajisin ato me njohuri, bazat e të dhënave ekonomike dhe instrumentet, në mënyrë që ato të shndërrohen në ura lidhëse midis interesave të Diasporës dhe bizneseve vendëse. Përpjekjet e tilla duhet të fillojnë duke i dhënë përparësi organizatave të biznesit dhe shoqatave brenda vendeve pritëse me bizneset më të mëdha të Diasporës dhe për këtë arsye – potencialet e mundshme të ndërveprimit ekonomik.

**2. Programi i Diasporës dhe komponentët e tij**

Metoda irlandeze me Diasporën e saj është metodë relativisht e suksesshme, veçanërisht në lidhje me biznesin, sepse është e asimilueshme dhe ka fleksibilitet në strukturë, u jep të drejta dhe liri anëtarëve të saj, dhe është gjeneruese pa qenë e ngurtë. Roli i shtetit në këtë kontekst është të ushqejë dhe afrojë rreth vetes, jo të menaxhojë dhe të përcaktojë.

Strategjia e Diasporës, e përforcuar nga kapacitetet e përmirësuara institucionale, strukturat ndërlidhëse të Diasporës, mekanizmat e koordinimit dhe shërbimet e përshtatura në të gjitha nivelet e qeverisë, ofron një mjedis të favorshëm për angazhimin e Diasporës në zhvillimin e atdheut. Bazuar në një hartëzim gjithëpërfshirës të Diasporës, komunikim të intensifikuar reciprok, shtrirje pro aktive nga autoritetet, dialog të strukturuar midis Diasporës dhe Shqipërisë, dhe me kontributin e Diasporës të njohur nga qeveria, rezulton në ngritjen e besimit dhe lidhjes më të fortë të Diasporës me atdheun e tyre dhe me njëri-tjetrin .

Shkëmbimi i fortë dhe transferimi i njohurive ndërmjet Diasporës, institucioneve dhe bizneseve në Shqipëri maksimizojnë mbështetjen e Diasporës për zhvillimin e qëndrueshëm dhe japin një kontribut të vlefshëm për adresimin e nevojave më urgjente të zhvillimit ekonomik të vendit duke inkurajuar investime dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

## 2.1 Vizioni dhe objektivat e programit

Ndryshimet në Shqipëri, veçanërisht për sa i përket politikës, reformave apo grupeve të mendjes, kanë një ritëm të ngadaltë. Prandaj, ndryshimet e ndikimit të parashikuara nga MSHD-ja janë me të vërtetë parashikime afatgjata të efekteve të dëshiruara, që rezultojnë nga puna sistematike dhe e drejtuar nga politika me institucionet, Diasporën dhe organizatat e tyre, sektorin privat, qeveritë lokale dhe mediet.

Për të garantuar një mjedis të favorshëm për angazhimin e Diasporës në zhvillimin e Shqipërisë, vendi duhet të zbatojë në mënyrë efikase strategjinë e angazhimit të Diasporës, e cila demonstron qartësisht dëshirën e autoriteteve për të bashkëvepruar me Diasporën dhe paraqet një vizion lidhur me mënyrën se si do të arrihet kjo përmes masave, mjeteve dhe burimeve të ndryshme. Të kesh një strategji për angazhimin e Diasporës është një faktor i rëndësishëm shtytës për veprim. Megjithatë, përveç nëse institucionet në të gjitha nivelet qeverisëse kanë njohuritë, aftësitë dhe burimet bazë për ta përkthyer strategjinë në programet dhe masat e tyre përkatëse, infrastrukturën institucionale që garanton "koordinimin me kohë të plotë me Diasporën", si dhe koordinimin ndërinstitucional, strategjia do të mbetet vetëm në letër. Përpjekjet për ta njohur më mirë Diasporën do të kontribuojnë në ndërtimin e besimit dhe angazhimin e vërtetë të Diasporës në zhvillimin e vendlindjes. Këto përpjekje duhet të përforcohen nga shërbime të përshtatura për Diasporën, të cilat mundësojnë qasje më të lehtë nga Diaspora. Të gjitha këto veprime do të bënin të mundur një qasje tërësore të qeverisë në angazhimin e Diasporës, duke ndërmarrë një strategji më të gjerë, aftësi institucionale dhe shërbime, të cilat nga ana tjetër krijojnë një mjedis të favorshëm për angazhimin e strukturuar të Diasporës në zhvillimin e vendlindjes. Në këtë proces, Programi do të marrë në konsideratë të gjithë faktorët e rëndësishëm dhe do të zbatojë masa për të lehtësuar rreziqet politike.

Lidhja më e fortë e Diasporës me Shqipërinë në planin afatgjatë do të sigurohet vetëm përmes qasjes së synuar dhe të hapur nga autoritetet, shoqëruar me një komunikim të rregullt të dyanshëm dhe angazhim të Diasporës në vendimmarrje dhe procese strategjike, të cilat mund të funksionojnë vetëm nëse qeveria është në dijeni të atyre që janë të gatshëm për të kontribuar dhe në cilat lloje të njohurive dhe ekspertizave. Ofrimi i mundësisë ndaj Diasporës për të kontribuar intelektualisht në zhvillimin e vendlindjes do të rriste ndjenjën e përkatësisë së tyre në Shqipëri, dhe në të njëjtën kohë do të krijonte besim ndërmjet Diasporës në nivel botëror dhe institucioneve vendëse. Në mënyrë që të arrijnë të sigurojnë një angazhim më të strukturuar dhe efektiv të Diasporës në debate strategjike vendore ose vendimmarrje, autoritetet duhet të lehtësojnë forcimin e organizatave të Diasporës brenda vendeve pritëse. Kjo përfshin jo vetëm fuqizimin dhe zgjerimin e rrjeteve ekzistuese, por edhe inkurajimin e konsolidimit dhe lidhjen e nëngrupeve dhe komuniteteve të ndryshme të Diasporës në vendet pritëse. Për këtë qëllim, mund të përdoren si teknologjitë moderne të informacionit ashtu edhe ato të komunikimit, si dhe rrjeti ekzistues zyrtar i përfaqësive konsullore dhe diplomatike të Shqipërisë në të gjithë botën.

Mobilizimi dhe maksimizimi i mbështetjes së Diasporës për zhvillimin e Shqipërisë është një vizion afatgjatë, i cili kërkon përpjekje serioze dhe të bashkërenduara nga institucionet vendëse, bizneset në Shqipëri dhe ato në Diasporë. Ky ndikim i dëshiruar është i ndërlidhur në mënyrë komplekse me politikën e gjerë dhe mjedisin mundësues institucional, si dhe me marrëdhëniet e besueshme midis Shqipërisë dhe Diasporës. Ndonëse Diaspora aktualisht është ende hezituese për të investuar ose zgjeruar biznesin në vendlindje, një potencial i tillë ekziston dhe mund të shfrytëzohet duke lehtësuar ndërveprimin e intensifikuar dhe të bazuar në interesa të përbashkëta ndërmjet bizneseve në vendet pritëse dhe Shqipërisë. Përgjatë këtij procesi, organizatat e biznesit në Diasporë luajnë një rol jetësor, si dhe qasje të synuar drejt qeverisjes lokale ose një niveli më të lartë. Transferimi i njohurive është një pjesë tjetër integrale e këtij ndërveprimi, duke pasur parasysh diapazonin e gjerë intelektual dhe teknologjik që mbart Diaspora. Transferimi i fokusuar i njohurive dhe aftësive mund të kontribuojnë shumë në trajtimin e nevojave më urgjente të zhvillimit të Shqipërisë – si rritja ekonomike dhe punësimi.

Qëllimi i përgjithshëm i Programit është si vijon: të zgjerojë mundësitë socio-ekonomike dhe perspektivat për gratë dhe burrat në Shqipëri, si dhe të përmirësojë jetesën e tyre duke rritur nivelin e angazhimit të Diasporës.

Programi nuk duhet të perceptohet si një zëvendësim i përpjekjeve të njësive qeverisëse përkatëse ose për të marrë përgjegjësinë e plotë për arritjen e një angazhimi efektiv dhe produktiv të Diasporës në zhvillimin vendlindjes. Prandaj, kjo ndërhyrje është si plotësuese ashtu edhe katalitike për përpjekjet e ndërmarra nga MSHD-ja, institucionet e tjera, dhe palët e interesuara të sektorit privat në Shqipëri, si dhe organizatat e tjera donatore.

MSHD-ja si institucioni kryesor në Shqipëri, përgjegjës për kuadrin e politikave dhe angazhimin me Diasporën do të kombinojë burimet, njohuritë dhe ekspertizën për zbatimin e Programit, duke punuar në bashkëpunim të ngushtë me partnerët e tij institucionalë brenda dhe jashtë vendit.

Logjika e përgjithshme për zbatimin e Programit është formuar nga tre komponentë që përforcojnë dhe ndërthuren në mënyrë të ndërsjellë. Këta komponentë paraqesin një grup indeksesh si sinergji ndërmjet objektivave të OKB-së për zhvillim të qëndrueshëm, prioritetet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, objektivat dhe masat e përfshira në politikën kombëtare të Diasporës, dhe më e rëndësishmja, rezultatet e programit.

Programi lidh funksionet normative dhe operative të administratës së ministrit të Shtetit për Diasporën dhe siguron strukturën e nevojshme për rritjen e efikasitetit, përgjegjshmërisë dhe kontrollit të punës së saj. Çdo komponent identifikon arritjet e pritshme të administrimit të MSHD-së si një e tërë dhe gjithashtu identifikon treguesit e duhur të arritjeve. Struktura e Programit përbëhet nga tri nënprograme – komponentë, të cilët lehtësojnë monitorimin e progresit strategjik, që përfshin të gjitha aktivitetet e larmishme të MSHD-së:

Objektivi i përgjithshëm:
Rritja e mundësive dhe perspektivës socio-ekonomike për gratë dhe burrat në Shqipëri dhe përmirësimi i jetesës nëpërmjet rritjes së angazhimit të Diasporës.

| Rezultati 1: | Rezultati 2: | Rezultati 3: |
| --- | --- | --- |
| MSHD-ja në bashkëpunim me institucionet qeveritare në nivele të ndryshe, përdor dhe zhvillon më tej instrumentet për t'u lidhur, shkëmbyer dhe angazhuar në mënyrë aktive me anëtarët dhe organizatat e Diasporës. | Bashkitë harmonizojnë strategjitë e tyre të zhvillimit me Strategjinë e Diasporës, ofrojnë shërbime më të shumta dhe më të mira për anëtarët e Diasporës dhe nxisin nismat e komunitetit për të tërhequr njohuritë dhe investimet nga Diaspora. | Partnerët e Diasporës transferojnë njohuritë dhe aftësitë dhe bëjnë investime të përbashkëta me aktorët e sektorit privat në Shqipëri, duke hapur kështu vende të reja pune. |

Rezultatet:

| | | |
| --- | --- | --- |
| Strategjia për Angazhimin e Diasporës, Plani i Veprimit dhe Kuadri i Monitorimit dhe Vlerësimit janë në zbatim e sipër nëpërmjet një qasje për përfshirjen tërësore të qeverisë. | Bashkitë janë të pajisura me strukturat, kapacitet dhe mjetet për t'u lidhur dhe krijuar partneritet me anëtarët e Diasporës. | Bizneset nga Diaspora dhe Shqipëria angazhohen në transferimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive me fokus tregun. |

## 2.2 Komponenti I. Qeverisja e përgjegjshme dhe mbështetja me anë të politikave reaguese

Arritjet e pritura sipas komponentit/ rezultatit 1 përfshijnë zbatimin me pjesëmarrje të strategjisë së angazhimit të Diasporës për Shqipërinë, si e para e këtij lloji për vendin, që krijon mundësinë për një platformë më të gjerë veprimi nga palët e interesuara publike me qasje të përfshirjes tërësore të qeverisë. Strategjia vë në funksion politikat e Diasporës, të hartuara nën kujdesin e ministrit të Shtetit për Diasporën me kontributet e përfaqësuesve të të gjitha institucioneve përkatëse qeveritare, dhe të miratuara me vendimin nr. 259/2018, të Këshillit të Ministrave. Gjatë këtij proceszbatimi, roli dhe kapaciteti i MSHD-së do të forcohet, për t'u shndërruar në koordinatorin e njohur drejtues në fushën e angazhimit të Diasporës nga palët e interesuara vendëse, si dhe nga Diaspora në nivel botëror. Aktivitetet sipas këtij rezultati do të kenë si synim kryesor institucionet në të gjitha nivelet e qeverisjes, të përforcuara nga krijimi proaktiv i urave lidhëse me publikun e gjerë në vend. Së fundi, strategjia e angazhimit të Diasporës do të përkthehet në mënyrë të suksesshme në veprime konkrete, nën koordinimin ndërinstitucional të udhëhequr nga MSHD-ja, por që zbatohen nga institucionet dhe njësitë qendrore e vendore, të cilat përmirësojnë aftësitë themelore institucionale duke angazhuar koordinatorë të Diasporës brenda strukturave të tyre. Gradualisht, nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe trajnimit të rregullt për mënyrat dhe mjetet për të angazhuar Diasporën për zhvillimin e Shqipërisë, përfaqësuesit e institucioneve të synuara (duke përfshirë politikëbërësit dhe stafin teknik), do të ndërgjegjësohen për potencialin e Diasporës në zhvillimin e Shqipërisë, dhe do të jenë në gjendje të hartojnë dhe ofrojnë politika lidhur me këtë sektori dhe masa nxitëse për Diasporën.

Aktivitetet e planifikuara për të arritur këtë rezultat nuk kanë për qëllim që të rrisin kapacitetet e të gjithë strukturës institucionale për angazhimin e Diasporës. Ato synojnë më së shumti të kontribuojnë për të hedhur themelet për politikat bazë, koordinimin dhe kuadrin institucional, të cilat janë të nevojshme për të zgjeruar dhe forcuar më tej ndërhyrjet në këtë fushë. Gjithashtu, veprimet sipas këtij rezultati do të kërkojnë të rrisin kapacitetet, të konsolidojnë dhe fuqizojnë organizatat e Diasporës, duke siguruar në këtë mënyrë angazhimin e tyre produktiv në debatet strategjike publike dhe krijimin e tyre si organe përfaqësuese si në vendet e tyre pritëse, ashtu edhe në njësitë qeverisëse të ndryshme në Shqipëri, në mënyrë që të bëjnë me dije sugjerimet dhe nevojat e tyre. Kontributet e këtyre organeve përfaqësuese por edhe të shoqatave të tjera të Diasporës do të njihen zyrtarisht nga autoritetet publike, edhe pse disa prej tyre tashmë janë të angazhuara në Shqipëri.

Në mënyrë që të ndërtohen kanaleve të qëndrueshme komunikimi dhe ndërveprimi të dyanshëm ndërmjet Diasporës dhe institucioneve vendëse, MSHD-ja do të kryejë një hartëzim gjithëpërfshirës të Diasporës dhe do të angazhohet me Diasporën me synime të qarta. Duke pasur parasysh këtë informacion në lidhje me Diasporën, MSHD-ja, në bashkëpunim me autoritetet e tjera përkatëse dhe palët e interesuara në Shqipëri dhe vendet pritëse do të lehtësojë transferimin e njohurive dhe aftësive për zhvillim, duke kontribuar kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë në forcimin e kapitalit njerëzor dhe rrjedhimisht në arritjen e objektivave që janë prioritet për zhvillimin e vendit.

Një faktor tejet thelbësor që do të merret në konsideratë gjatë përpjekjeve për të arritur rezultatin 1 ka të bëjë me angazhimin politik të institucioneve përkatëse për t'u angazhuar dhe për të punuar në mënyrë produktive që të krijojnë një mjedis më të mirë për angazhimin e Diasporës. Me rëndësi të përmendet është që Programi do të mbështesë dhe do të fuqizojë MSHD-në në rolin e të caktuar si organi kryesor qeveritar për angazhimin e Diasporës. Për të arritur që MSHD-ja të jetë në gjendje të marrë në mënyrë efektive rolin e koordinatorit udhëheqës, Programi duhet të investojë gjithashtu në rritjen e kapaciteteve dhe trajnimin e institucioneve të tjera qeveritare në nivel kombëtar, entiteti dhe vendor në mënyrë që të funksionojë qasja e përfshirjes tërësore të qeverisë.

## 2.3. Komponenti II. Edukimi dhe hulumtimi për një mjedis të qëndrueshëm

Rezultatet e pritshme sipas komponentit/ rezultatit 2 kanë për qëllim të rrisin aftësinë e bashkive në Shqipëri për të bashkëvepruar dhe për të angazhuar Diasporën në drejtim të zhvillimin vendor, i cili nga ana tjetër do të aktivizojë kontributin e Diasporës në investime dhe jetesën në komunitetet të synuara. Për këtë arsye, aktivitetet sipas këtij rezultati do të synojnë kryesisht bashkitë e zgjedhura, shërbimet e tyre dhe Diasporën. Aktivitetet sipas këtij rezultati do të kontribuojnë në thellimin ose forcimin e funksionit të koordinimit të Diasporës, si dhe do të zgjerojnë njohuritë për këtë çështje në administratat vendore.

Kështu, bashkitë do të përmirësojnë në mënyrë të prekshme komunikimin me Diasporën dhe organizatat e tyre, dhe në të njëjtën kohë do të shfrytëzojnë mundësitë për partneritete zhvillimi ndërterritoriale me autoritetet nënkombëtare në vendet pritëse me numrin më të madh të anëtarëve të Diasporës përmes marrëveshjeve të partneriteteve dhe veprimeve konkrete ndërmjet qeverive lokale/kantonale nga Shqipëria dhe atyre të vendeve pritëse. Pjesë thelbësore e këtij procesi janë mjetet e përmirësuara administrative, informative dhe të komunikimit, të cilat mundësojnë që qeveritë vendore të arrijnë të komunikojnë me Diasporën me synime të qarta, sidomos me bizneset e Diasporës.

Këto arritje do të përforcohen drejtpërdrejt nga planifikimi i zhvillimit vendor që lidhet me Diasporën, si dhe nga nismat konkrete që lidhin Diasporën me komunitetet vendlindjes dhe kontribuojnë në zhvillimin ekonomik vendor. Promovimi i investimeve nga Diaspora, do të jetë në fokus, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik vendor, krijimin e të ardhurave dhe hapjen e vendeve të punës.

Për të gjitha bashkitë partnere është parashikuar mbështetje e kufizuar financiare, bazuar në propozimet e programeve cilësore. Njohuritë mbi programet dhe praktikat më të mira do të shpërndahen gjerësisht përmes rrjetëzimit, duke aktivizuar kështu efektin domino që arrin jo vetëm te grupet e synuara, por edhe më gjerë. Angazhimi i mund të shndërrohet në aset të vlefshëm për zhvillimin e komunitetit në mënyra të ndryshme, si duke përforcuar komunitetin vendor, duke transferuar njohuritë dhe investimet, ose duke i hapur dyert për në botë më të gjerë.

### 2.4 Komponenti III. Sipërmarrja dhe investimet e përbashkëta për një rritje gjithëpërfshirëse

Rezultatet sipas komponentit/ rezultatit 3 do të maksimizojnë kontributin e Diasporës për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, të konfirmuar përmes shkëmbimit të njohurive dhe aftësive ndërmjet bizneseve, si dhe ndërveprimit në bazë të interesave dhe shkëmbimit ndërmjet bizneseve nga Diaspora dhe Shqipëria. Të gjitha këto përkthehen përfundimisht në investime dhe vende të reja pune. Bizneset nga i gjithë vendi do të mund të përfitojnë nga mbështetja e Programit. Në natyrën e tij, ky rezultat i Programit është një laborator i njohurive dhe praktikave, që synon të stimulojë, lehtësojë dhe mbështesë rezultate konkrete të zhvillimit ekonomik, duke angazhuar një gamë të gjerë institucionesh dhe organizatash vendëse përkatëse, rrjete biznesi nga Diaspora dhe Shqipëria, qendra teknologjike, inkubatorë biznesi dhe biznese të reja (*start-up*). Për më tepër, në një këndvështrim më të gjerë, këto aktivitete pritet po ashtu të nxisin lidhje dhe besim më të fortë ndërmjet njerëzve nga Diasporës dhe atyre në Shqipëri.

## 3. Kuadri i menaxhimit

### 3.1 Menaxhimi dhe koordinimi

Ministri i Shtetit për Diasporën [MSHD] është aktori kryesor institucional dhe "pronari" qeveritar i rezultateve të Programit. Për këtë arsye, MSHD-ja do të punojë ngushtë me partnerët zbatues të Programit dhe do të garantojë transferimin e njohurive dhe kapaciteteve, si dhe pozicionimin e mëtejshëm të MSHD-së si një institucion kryesor koordinues përgjegjës për angazhimin e Diasporës në Shqipëri.

Partnerët zbatues do të marrin përsipër përgjegjësinë e përgjithshme financiare dhe të programimit për zbatimin e Programit, duke punuar në bashkëpunim me MSHD-në, dhe në bashkëpunim të ngushtë me ministritë e linjës dhe qeveritë vendore.

Një modalitet i zbatueshëm fleksibël do të zbatohet bazuar mbi faktin se kapacitetet institucionale dhe administrative pjesë e palëve të interesuara kombëtare (ministritë e linjës,

qeverisja vendore) nuk janë ende plotësisht të mjaftueshme për të ndërmarrë funksione dhe aktivitete thelbësore, si dhe duke pasur parasysh potencialin e lartë të partnerëve institucionalë për efektivitet maksimal të kostos dhe zhvillimin fleksibël të aftësive të përshtatshme. Megjithatë, MSHD-ja do të kërkojë, kur është e mundur, përfshirjen e fortë të partnerëve të ndryshëm, me fokus në qeverisjen vendore, të cilat, nëse vërtetojnë se kanë kapacitete të mjaftueshme, mund të marrin përsipër në përfundim zbatimin e komponentëve të programit dhe nënprogrameve përmes procedurës me nënkontraktim. Partnerët zbatues të programit do të garantojnë se të gjithë partnerët dhe nënkontraktorët do të zgjidhen bazuar në proceset e përzgjedhjes së hapur dhe transparente, duke siguruar: i) një lidhje të qartë ndërmjet zbatimit dhe komponentëve të politikave, ii) efektivitetin e kostos, iii) qëndrueshmërinë e masave për rritjen e kapaciteteve.

**3.2 Monitorimi dhe vlerësimi**

Struktura organizative do të jetë si më poshtë:

Bordi i Programit do të jetë grupi përgjegjës për marrjen me konsensus të vendimeve menaxhuese për Programin kur kërkohet udhëzim nga menaxheri i Programit. Bordi i Programit miraton planet vjetore të punës, mbikëqyr ecurinë e përgjithshme të zbatimit dhe autorizon çdo devijim madhor prej tyre. Ai ofron udhëzime strategjike, si dhe jep miratimin përfundimtar për çështje të përzgjedhura strategjike dhe operacionale. Gjithashtu, garanton që burimet e kërkuara janë të angazhuara dhe arbitron çdo konflikt brenda Programit ose negocion zgjidhje për çdo problem ndërmjet programit dhe organeve të jashtme. Bordi i Programit mblidhet të paktën dy herë në vit, ose sipas nevojës kur kërkohet nga Menaxheri i Programit. Anëtarët e Bordit të Programit janë përfaqësues të lartë të MSHD-së, agjencive donatore, partnerëve zbatues dhe bashkive. Kabineti i MSHD-së shërben si sekretariat pranë Bordit të Programit, dhe është përgjegjës për dërgimin e ftesave për mbledhjet e Bordit të Programit, përgatitjen e agjendës dhe materialeve për mbledhjet, si dhe hartimin e procesverbaleve të mbledhjeve.

Partnerët zbatues janë përgjegjës për menaxhimin e efektshëm dhe të paanshëm në mirëbesim dhe raportimin financiar. Ai merr kontribute nga donatorët, shpërndan fondet te nënkontraktrorët vendorë, partnerët dhe do të konsolidojë raportet periodike financiare dhe raportin financiar përfundimtar. Gjithashtu, do të jetë përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve programatike, duke përfshirë koordinimin dhe përpilimin e planeve vjetore të punës dhe raporteve narrative, monitorimin e objektivave vjetorë, thirrjen dhe raportimin në takimet e Bordit të Programit, lehtësimin e vlerësimeve dhe raportimin mbrapsht te Bordi i Programit. Përveç rolit udhëheqës të zbatimit, partneri zbatues do të ketë në veçanti në ngarkim zbatimin e aktiviteteve sipas rezultateve 1, 2 dhe 3 të Programit.

Ministri i Shtetit për Diasporën, si institucioni kryesor qeveritar për angazhimin e Diasporës do të jetë partneri dhe përfituesi kryesor i Programit, dhe si i tillë, do të caktojë një pikë kryesore kontakti për Programin, i cili do të përfaqësojë MSHD-në në Bordin e Programit. Megjithatë, stafi përkatës i MSHD-së do të përfshihet në zbatimin e programit kur bëhet fjalë për lehtësimin dhe sigurimin e inputeve për takimet koordinuese, takimet për dialogun e politikave me shoqatat e Diasporës dhe seminare trajnimi për nëpunësit civil. Stafi i MSHD-së do të kryesojë mbledhjet kur bëhet fjalë për krijimin e organeve përfaqësuese të Diasporës. Ata do të trajnohen për zbatimin e hartëzimit të Diasporës, krijimin e skemës së transferimit të njohurive dhe platformës së marrjes së shërbimeve nga një numër i madh njerëzish, si dhe mirëmbajtjen e platformës së Diasporës në internet. Po ashtu, stafi i MSHD-së do të përfshihet në zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në rezultatet e tjera (veçanërisht kur bëhet fjalë për zhvillimin e kapaciteteve, shkëmbimin mes kolegësh, duke siguruar lidhje midis aktiviteteve në nivel të politikave në nivelet më të larta të qeverisjes dhe atyre në nivel vendor/ kantonal dhe promovimi i rezultateve, si dhe promovimin i kontributit të Diasporës në zhvillimin e vendit).

Roli i garantimit të cilësisë së Programit do të mbështesë Bordin e Programit, duke kryer funksione objektive të mbikëqyrjes dhe monitorimit. Ky rol garanton menaxhimin dhe arritjen e pikave kryesore përkatëse të programit. Garantimi i cilësisë së programit është i pavarur nga menaxheri i Programit. Roli i garantimit të sigurisë së Programit do të kryhet nga partneri

zbatues. Në nivel teknik, përfaqësuesit nga MSHD-ja dhe partnerët zbatues do të organizojnë mbledhje të rregullta (çdo muaj), për të garantuar shkëmbimin e ecurisë, zhvillimeve, diskutimin e sinergjive dhe ideve konkrete.

**Struktura e ekipit të programit**

Ekipi i Programit do të drejtohet nga menaxheri i Programit (me kohë të plotë pune), i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm të Programit dhe menaxhimin ditor të rezultateve 2 dhe 3, dhe do të garantojë që Programi të prodhojë rezultatet e specifikuara, me standardet e kërkuara të korporatave dhe brenda kufizimeve kohore dhe të kostove.

Komunikimi dhe ndërveprimi i rregullt ndërmjet ekipit të Programit, duhet të garantohet veçanërisht ndërmjet stafit të zyrave të Agjencisë Kombëtare për Diasporën.

Një koordinator kombëtar i Programit (me kohë të plotë pune) do të jetë përgjegjës për koordinimin e zbatimit të aktiviteteve çdo ditë sipas rezultatit 1 dhe do të punojë ngushtë me MSHD-në dhe pjesën tjetër të ekipit të Programit. Përgjegjësitë kryesore do të përfshijnë, gjithashtu: i) garantimin e mbështetjes teknike, mbikëqyrjen dhe garantimin e kryerjes në kohë të aktiviteteve dhe shpenzimit të fondeve në funksion të rezultateve sipas rezultatit 1; ii) mbledhjen dhe hulumtimin e të dhënave autorizuese iii) kryerjen e vlerësimit të kapaciteteve; iv) organizimin e kontakteve me grupe të ndryshme të palëve të interesuara; v) përgatitjen e inputeve për mbledhjet e Bordit të Programit; vi) zhvillimin e raporteve për zbatimin e rezultatit 1, në përputhje me kuadrin logjik dhe treguesve të progresit të Programit.

Një këshillues për zhvillimin e politikave dhe kapaciteteve (me kohë të pjesshme) do të veprojë si lehtësues dhe trajner i aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve; duke rishikuar raportet dhe duke siguruar të dhëna për dokumentet strategjike; duke ofruar këshilla në nivel eksperti në fushat e kërkuara të ekspertizës; duke mbështetur mekanizmat e koordinimit ndërministror dhe multipalësh (duke përfshirë organizimin e mbledhjeve, kontributin thelbësor dhe vijues).

Një nëpunës i lartë kombëtar nga qeverisja vendore dhe një nëpunës i mesëm (me kohë të plotë pune) do të mbështesin dhe menaxhojnë zbatimin e aktiviteteve sipas rezultatit 2. Përgjegjësitë kryesore të nëpunësit nga qeverisja vendore do të përfshijnë: i) ofrimin e udhëzimeve të përgjithshme dhe këshillave teknike për menaxherin e Programit dhe partnerët e qeverisjes vendore në përpjekjet e tyre për të përforcuar njohuritë dhe mjetet për angazhimin e Diasporës, si dhe për të prezantuar strategjitë lokale që përfshijnë Diasporën dhe masa publike nxitëse; ii) programimin udhëzues të ndihmës teknike dhe paketave të trajnimit për qeverisjen vendore partnere; iii) ofrimin e mbështetjes teknike për qeverisjen vendore në procesin e lidhjes me bashkitë, qytetet ose rajonet e tjera në vendet me numër të madh të popullsisë së Diasporës, si dhe me bizneset vendore dhe të Diasporës; iv) zhvillimi i raporteve për zbatimin e rezultatit 2, në përputhje me kuadrin logjik dhe treguesit e progresit të Programit. Nëpunësi i mesëm nga qeverisja vendore (me kohë të plotë pune) do të mbështesë menaxherin e programit dhe nëpunësin e lartë nga qeverisja vendore për të ofruar mbështetje për Programin për qeverisjen vendore partnere, veçanërisht duke qenë përgjegjës për: i) udhëheqjen e koordinimit, rrjetëzimit dhe ndërveprimit midis qeverisjes lokale në fushën e angazhimit të Diasporës për zhvillimin lokal; ii) mbështetjen duke ofruar trajnime dhe asistencës teknike dhe garantim të cilësisë; iii) bashkëpunimin me qeverisjen vendore për të identifikuar dhe zbatuar programe vendore që angazhojnë Diasporën; iv) ndihmën në përfshirjen e konceptit të përfshirjes së Diasporës në strategjitë vendore.

Aktivitetet e rezultatit 3 do të zbatohen nga një nëpunësi lartë dhe një i mesëm për zhvillimin ekonomik kombëtar (me kohë të plotë pune). Funksionet kryesore të nëpunësit të lartë për zhvillimin ekonomik përfshijnë: i) hartimin dhe garantimin e cilësisë gjatë ofrimit të proceseve të asistencës në lidhje me aktivitetet sipas rezultatit 3; ii) hartimin dhe menaxhimin e ndihmës në lidhje me transferimin e njohurive ndërmjet bizneseve; iii) identifikimin dhe lehtësimin në mënyrë proaktive të lidhjeve ndërmjet bizneseve dhe ndërveprimin mes bizneseve dhe organizatave të Diasporës, dhe bizneseve në Shqipëri; iv) hartimin dhe menaxhimin e ndihmës në lidhje me

investimet e Diasporës në vend dhe nismat pilot për *startup*-et; v) identifikimin dhe shfrytëzimin e mundësive për sinergji me nismat e tjera përkatëse të zhvillimit ekonomik në nivel vendor.

Nëpunësi i mesëm për zhvillim ekonomik do të mbështesë menaxherin e Programit dhe nëpunësin e lartë për zhvillim ekonomik gjatë ofrimit të mbështetjes së Programit për palët e interesuara nga sektori privat, dhe do të jetë përgjegjës veçanërisht për: i) koordinimin, rrjetëzimin dhe bashkëveprimin ndërmjet shoqërive nga Shqipëria dhe Diaspora; ii) mbështetjen e modelimit dhe zbatimit të granteve tematike/ ndihmave financiare që synojnë nxitjen e shkëmbimit në sektorin privat dhe përfshirjen e Diasporës në zhvillimin ekonomik të vendit; iii) monitorimin dhe sigurimin e cilësisë për zbatimin e granteve për Diasporën dhe sektorin privat; iv) mbështetjen e shkëmbimit të praktikave më të mira në fushën e kontributit të Diasporës për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë; v) mbështetjen e procesit të përforcimit të kapaciteteve të organizatave të biznesit të Diasporës.

Mbështetja e përgjithshme financiare, administrative dhe logjistike do të sigurohet përmes 1 bashkëpunëtori të Programit (me kohë të plotë pune), 1 asistenti për zhvillimin e kapacitetit institucional për Programin (me 80% kohë pune) dhe 1 bashkëpunëtori financiar për Programin (me 60% kohë pune), si dhe prokurimit të kufizuar dhe ndihmës administrative.

Për më tepër, programi do të angazhojë, me kohë të pjesshme, një specialist për monitorimin dhe vlerësimin (me 20% kohë pune), si dhe një specialist për komunikimet/ marrëdhëniet me publikun (me 40% kohë pune). Gjithashtu, Programi do të caktojë disa specialistë kryesorë afatshkurtër kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të mbështetur zbatimin e Programit, ndër të cilët disa do të jenë ekspertë për migracionin dhe zhvillimin; për mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave të emigracionit; për politikat e Diasporës; për mbledhjen e informacioneve nga publiku; për portalet në internet dhe strategjitë e komunikimit; për angazhimin e Diasporës; për teknologjitë e komunikimit dhe informacionit; për qeverisjen dhe politikat.

**3.3 Rreziqet dhe masat lehtësuese**

Këto masa janë mekanizma të menaxhimit të mbikëqyrjes për të përmirësuar performancën, për pozicionimin strategjik largpamës, për të nxënit organizativ dhe për menaxhimin e shëndoshë.

**Monitorimi**

Programi do të monitorohet dhe do të vlerësohet në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me kërkesat specifike të qeverisë, si edhe me programet e donatorëve që kontribuojnë për këtë program.

Monitorimi i programit do të kryhet në mënyrë periodike në formën e raporteve që karakterizohen nga qasja e ndjeshme ndaj aspekteve gjinore. Mjetet kryesore për organizimin e sistemit të monitorimit të programit përfshijnë sa më poshtë:

- kuadrin logjik të ndjeshëm ndaj aspekteve gjinore;
- analizën e rrezikut të programit.

**Vlerësimet**

Programi do t'i nënshtrohet një vlerësimi të pavarur në çdo vit të zbatimit të saj. Ai do të organizohet dhe financohet drejtpërdrejt nga agjencitë donatore si mjet për të verifikuar përputhshmërinë, dhe se burimet janë menaxhuar si duhet, fondet janë shfrytëzuar mirë dhe shpenzuar në mënyrë transparente. Vlerësimi organizohet si proces sistematik për të analizuar objektivat në lidhje me përputhshmërinë, efektivitetin, efikasitetin dhe ndikimin e aktiviteteve të zbatuara/ ndërmarra nga pikëpamja e objektivave të specifikuar. Kjo do të jetë e dobishme për të ofruar rekomandime dhe mësime të nxjerra për ekipet e zbatimit të projektit për të përmirësuar menaxhimin e rezultateve për projektet aktuale dhe ato të ngjashme në të ardhmen, në mënyrë që të shmangen përsëritjet, gabimet dhe vonesat, si dhe të përcaktohen dhe promovohen mekanizmat e suksesshëm dhe sjellja e mirë, dhe më e rëndësishmja të ofrohet qëndrueshmëri veprimesh.

**Raportimi**

Në bazë të inputeve të arritjeve dhe aktiviteteve të organizuara, partnerët zbatues do të përgatisin raporte periodike narrative, si dhe raporte të hollësishme financiare, sipas kërkesave të institucioneve donatore.

Zyra e Zbatimit dhe Koordinimit të Programit [PICO], do të: i) përgatisë raporte të konsoliduara narrative dhe të progresit financiar, në bazë të raportin narrativ të konsoliduar të përgatitur nga ekipi i programit dhe pasqyrat financiare të dorëzuara; ii) ofrojë raportet e konsoliduara për bordin e Programit dhe donatorët. Këto raporte do të përfshijnë:

- raportet vjetore narrative të progresit;
- raportin narrativ përfundimtar;
- pasqyrat financiare vjetore të certifikuara;
- pasqyrat financiare përfundimtare të certifikuara.

Rreziqet kryesore që lidhen me zbatimin e Programit janë identifikuar në tabelën 1 më poshtë, së bashku me probabilitetin e ndodhjes, llojet e ndikimeve në Program, si dhe masat e duhura zbutëse. Në përgjithësi, niveli i rrezikut për këtë program vlerësohet si "i mesëm – i lartë", kryesisht për shkak të faktorëve politikë.

| Rreziqet e përgjithshme | Mundësia | Lloji / ndikimi | Përgjigja e programit |
|---|---|---|---|
| Besim i ulët ndërmjet Diasporës dhe institucioneve qeveritare dhe mosdashje e mundshme e organizatave të Diasporës për të punuar me institucionet e Shqipërisë | I mesëm – i lartë | Institucional / i mesëm (mosbesimi në institucionet në Shqipëri mund të ndërhyjë në krijimin e marrëdhënieve funksionale) | Programi do të nxisë qasje proaktive dhe me fokus Diasporën në të gjitha nivelet e qeverisjes, të cilat gradualisht do të kontribuojnë në krijimin e besimit nga Diaspora me qeverisjen e vendlindjes. Gjithashtu, Diaspora do të ftohet të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes dhe hartimin e politikave. Programi mund të bazohet gjithashtu në marrëdhëniet dhe partneritetet të cilat janë krijuar nga organizatat zbatuese, format ekzistuese të bashkëpunimit me organizatat e Diasporës që gëzojnë besimin e bashkësive të Diasporës në vendet pritëse. |
| Polarizimi i Diasporës çon në mungesën e vullnetit për të bashkëpunuar brenda organit përfaqësues; përkatësia e organeve përfaqësuese | E lartë | Politik /i lartë (komunikim i kufizuar me Diasporën, vështirësi në përfshirjen e Diasporës me formim të ndryshëm politik në hartimin e politikave, si dhe në dialogun e politikave, motivimi për pjesëmarrjen e organizatave të Diasporës mund të zvogëlohet falë përkatësisë politike) | Ndërhyrjet do të kontribuojnë në ndërtimin e urave dhe forcimin e kohezionit përmes krijimit të kanaleve të reja të komunikimit dhe pjesëmarrjes së Diasporës. Do të ofrohet mbështetje në krijimin e organeve përfaqësuese të Diasporës në një vend pritës pilot, i cili mund të përfaqësojë komunitete të Diasporës vis-à-vis/përballë partnerëve qeveritarë dhe joqeveritarë të vendit pritës ose vis-a-vis autoriteteve të Shqipërisë. Nëse ky model do të rezultojë i suksesshëm, ai do të përsëritet në një vend tjetër në kuadër të këtij programi. Në këtë proces, MSHD-ja do të bashkëpunojë ngushtë me misionet diplomatike, duke vendosur një qasje gjithëpërfshirëse dhe duke ftuar/angazhuar shoqata, grupe dhe individë të Diasporës nga të gjitha prejardhjet në vendet e synuara. Ata do të vendosin vetë për mekanizmat, format dhe fushëveprimin e bashkëpunimit. Qasjet e mos përfshirjes në politikat e përditshme por të përqendrimit në tema të zakonshme, jopolemike që janë në vëmendje të të gjithëve, duke ndjekur mënyrën transparente dhe pjesëmarrëse të punës. |
| **Rreziqet e përgjithshme** | **Mundësia** | **Lloji / ndikimi** | **Përgjigja e programit** |
| Interesi dhe mbështetja e përfaqësimeve diplomatike të Shqipërisë në vendet pritëse janë të pamjaftueshme | I ulët | Institucional / i ulët (shtrirje e limituar ndaj anëtarëve të Diasporës, mungesë mbështetjeje në ngritjen e organeve përfaqësuese të Diasporës) | Si MSHD-ja dhe MPJ-ja janë të përkushtuar që t'u drejtohen ambasadave në vendet përkatëse, duke rritur ndërgjegjësimin dhe duke kërkuar angazhim më pro aktiv të personelit të tyre, e cila konfirmohet edhe nga ministri i Punëve të Jashtme. Programi do të bashkëpunojë me organizatat e Diasporës për të advokuar për një angazhim më të fortë nga ambasadat. Përvoja në angazhimin e ambasadës (përfaqësimi diplomatik dhe konsullor) në krijimin e organit përfaqësues në vendin e zgjedhur do të promovohet për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të mobilizuar interesin e misioneve të tjera diplomatike në Shqipëri. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Mungesa e transparencës dhe pjesëmarrja në procesin e këshillimit për krijimin e organeve përfaqësuese dhe aktivitetet e parashikuara në Shqipëri | I ulët në të mesëm | Institucional / i ulët (nëse procesi i propozimit të përfaqësuesve në organin përfaqësues në vendet pritëse nuk është i drejtë dhe transparent për të gjithë, ka të ngjarë që organizatat e Diasporës dhe anëtarësimi i tyre nuk do të jetë i motivuar për të mbështetur themelimin dhe aktivitetet e tyre) | Duke pasur parasysh besimin e brishtë midis organizatave të Diasporës në vendet pritëse, por gjithashtu përgjithësisht midis individëve me prejardhje të ndryshme etnike, komunikimi do të jetë një nga aspektet më të rëndësishme të zbatimit të Programit (strategjia e komunikimit). Në këshillim me organizatat / individët e Diasporës, anëtarët e organeve përfaqësuese do të zgjidhen nga një proces përzgjedhjeje shumë i kujdesshëm. Rolet dhe përgjegjësitë do të përcaktohen me protokollin e nënshkruar nga përfaqësimi diplomatik dhe organi përfaqësues me praninë e MSHD-së dhe/ose MPJ-së dhe aty ku përfaqësuesi i disponueshëm i autoriteteve të vendit pritës dëshmojnë themelimin zyrtar. |
| Interesat e ndryshme politike dhe vonesa ose mos aprovimi i strategjisë së rishikuar të Diasporës | I mesëm | Politike / i lartë (jo të gjitha nivelet e qeverisë përfshihen në aktivitetet e Programit; vonesat në miratimin e Strategjisë së rishikuar të Diasporës dhe zbatimin e saj pasues në të gjitha nivelet e qeverisë) | MSHD-ja do të përpiqet të sigurojë pjesëmarrjen e palëve të interesuara të qeverisë në nivele të ndryshme për të kapërcyer çdo vonesë në miratimin dhe zbatimin e Strategjisë së rishikuar të Diasporës, e cila do të ishte një bazë për zhvillimin e masave të mëtejshme të Angazhimit të Diasporës. Nëse Strategjia e Diasporës ende nuk do të miratohet, në Strategjinë e Angazhimit të Diasporës, Programi do të përpunojë dhe zbatojë ato masa që janë tashmë të listuara në Planin e Veprimit të 2018–2024, siç janë: forcimi i kapaciteteve të MSHD-së dhe mbështetja e institucioneve të tjera në të gjitha nivelet e qeverisë dhe shoqërisë civile me qëllim përfshirjen e Diasporës për të kontribuar në zhvillimin e Shqipërisë dhe për të zhvilluar një sistem për monitorimin e tendencave të emigracionit. Të gjithë përbërësit e parashikuar të programit mund të realizohen nën masat e lartpërmendura, përveç aktiviteteve që lidhen me zhvillimin e Strategjisë. Gjithashtu, nëpërmjet ndërhyrjeve të tjera të zbatuara si pjesë e Programit, do të bëhen përpjekje për të rritur mbështetjen e qeverisë vendore për punën e politikave. |
| **Rreziqet e përgjithshme** | **Mundësia** | **Lloji / ndikimi** | **Përgjigja e programit** |
| Zgjedhjet e përgjithshme dhe ndryshimi eventual i udhëheqjes politike të qeverisë dhe angazhimi i tyre në agjendën e angazhimit të Diasporës | I mesëm | Politike / e mesme (agjenda e politikës së Diasporës është vonuar) | Së bashku me partnerët zbatues të MSHD-së, do të bëhen përpjekje për të familjarizuar zyrtarët e sapozgjedhur dhe politikëbërësit e nivelit më të lartë me qëllimin e Programit dhe duke i motivuar ata të përfshihen në zbatimin e tij. Funksionet institucionale, sa më shumë që të jetë e mundur (pikat e kontaktit të Diasporës) do të zyrtarizohen, ndërsa informacioni, faqet e internetit, mjetet etj., do të promovohen gjerësisht ndërmjet administratave në institucionet vendore, kantonale, të entitetit dhe të shtetit. |
| Bizneset nuk dëshirojnë të investojnë në Shqipëri | I mesëm | Financiar / i lartë (vështirësi në realizimin e investimeve të Diasporës në vend) | Programi do të lehtësojë ndërveprimin dhe partneritetin midis biznesit në vendet pritëse dhe në Shqipëri, shoqëruar me afrim proaktiv nga qeveritë dhe masa nxitëse që stimulojnë bizneset e Diasporës për të investuar në Shqipëri. Këto përpjekje do të forcohen duke përmirësuar shërbimet vendore dhe informacionin për Diasporën, lulëzimin e dialogut ndërmjet Diasporës dhe autoriteteve në vend, publikimin e historive të suksesit në platformat e shkëmbimit të informacionit dhe informacionit transparent rreth mundësive të investimit. |

## 4. Kuadri ligjor

Në ngjashmëri me aktorët e tjerë joshtetërorë, një mjedis favorizues për pjesëmarrjen e Diasporës në zhvillim kërkon: a) korniza efektive të politikave, ligjore dhe rregulluese; b) aftësia institucionale në të gjithë sektorët dhe në nivele të ndryshme; c) një prirje për qeverinë që të kërkojë dhe t'u përgjigjet nevojave dhe preferencave të qytetarëve; d) një gamë e mekanizmave të mbikëqyrjes, përgjegjësisë dhe reagimit; dhe e) burimet dhe investimet publike. Në rastin e kontributeve të Diasporës, pyetjet për vlerësimin e një mjedisi favorizues për kontributet e Diasporës përfshijnë:

- A mbështet mjedisi rregullues mundësitë ekonomike?

- A kanë anëtarët e Diasporës qasje në pozitat e autoritetit dhe respektit brenda për brenda shoqërisë, për të pasur një ndikim si dhe për t'i marrë këto pozita për veten e tyre?
- A kanë akses ndaj dhe aftësi për të influencuar marrësit e vendimeve?
- A kanë akses ndaj informacioneve të nevojshme ose mbështesin efektivitetin e tyre për një agjendë të caktuar?
- A perceptohet shkaku i tyre si legjitim?
- A kanë akses në burimet materiale?

Për t'iu përgjigjur këtyre kritereve krahasuese dhe në përpjekje për të krijuar një praktikë politikash të përgjegjshme dhe reaguese për angazhimin e Diasporës, në vijim paraqitet një listë jo e plotë e legjislacionit shqiptar të miratuar, që shërben për këtë qëllim:

- Vendimi nr. 98/2017, datë 5.10.2017 "Për ngritjen e nënkomisionit 'Për diasporën dhe migracionin'", në përbërje të komisionit të përhershëm parlamentar për politikën e jashtme;
- Vendimi nr. 510, datë 13.9.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Diasporën";
- Vendimi nr. 690, datë 22.11.2017 "Për krijimin dhe funksionimin e Komitetit Shtetëror për Diasporën";
- Urdhër nr. 231, datë 7.12.2017 "Për përbërjen dhe detyrat e Sekretariatit Teknik të Komitetit Shtetëror për Diasporën";
- Vendimi nr. 259, datë 9.5.2018 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018–2024 dhe plani i veprimit";
- Vendimi nr. 400, datë 19.6.2019 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Emigracionin dhe plani i tij kombëtar 2019–2022";
- Urdhër nr. 98, datë 16.7.2018 "Për përcaktimin e grupit të koordinatorëve për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018–2024";
- Urdhri nr. 43, datë 12.2.2019 "Për caktimin e koordinatorit të shtetit për marrëveshjet shtetërore në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptar jashtë vendit";
- Urdhri nr. 78, datë 17.4.2019 "Për emërimin e koordinatorit të shtetit për marrëveshjet shtetërore në fushën e njohjes së lejeve dhe licencave të drejtimit të mjetit për shtetasit shqiptar jashtë vendit";
- Urdhri nr. 47, datë 18.2.2019 "Për emërimin e koordinatorit të shtetit për programe/donatorë që ofrojnë bursa jashtë vendit";
- Urdhri nr. 44, datë 12.2.2019 "Për emërimin e koordinatorit të shtetit për organizimin e programit vjetor të aktiviteteve për diasporën shqiptare";
- Urdhri nr. 45, datë 12.2.2019 "Për emërimin e koordinatorit të shtetit për marrëveshjet shtetërore në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit";
- Urdhri nr. 45, datë 12.2.2019 "Për emërimin e koordinatorit të shtetit për dhënien e informacionit në Diasporë";
- Urdhri nr. 124, datë 18.9.2019 "Për krijimin e një grupi ndërinstitucional të punës për hartimin e një pakete ligjore për të garantuar të drejtën e votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë";
- Urdhri nr. 92, datë 2019.5.17 "Për krijimin e një grupi pune dhe përcaktimin e personit përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të shtetasve shqiptarë të burgosur jashtë vendit dhe të drejtat e emigrantëve duke siguruar informacione se si të apelohet kundër shkeljeve të të drejtave të tyre përmes strukturave ndërkombëtare dhe atyre të vendeve pritëse";
- Urdhri nr. 135, datë 13.9.2018 "Për krijimin e një grupi ndërinstitucional të punës për zbatimin e masës 64 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës";
- Urdhri nr. 136, datë 13.9.2018 "Për krijimin e një grupi ndërinstitucional të punës për zbatimin e masës 51 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Hartimit";
- Urdhri nr. 137, datë 13.9.2018 "Për krijimin e një grupi ndërinstitucional të punës për zbatimin e masës 15 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Hartimit";

- Urdhri nr. 138, datë 13.9.2018 "Për krijimin e një grupi ndërinstitucional të punës për zbatimin e masës 2 dhe 45 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Hartimit";

- Urdhri nr. 55, datë 25.3.2019 "Për përjashtimin e urdhrave të Kryeministrit nr. 135, datë 13.9.2018, nr. 136, datë 13.9.2018 dhe nr. 138, datë 13.9.2018";

- Raport mbi deklaratën e drejtorëve nr. 135, nr. 136 dhe nr. 138 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës;

- Raporti i përjashtimit të urdhrave nr. 135, nr. 136 dhe nr. 138 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën;

- Ligji nr. 16/2018, datë 5.4.2018 "Për diasporën";

- Vendimi nr. 339, datë 6.6.2018 "Për kriteret e përzgjedhjes dhe dhënien e çmimit 'Ambasadori i Kombit'";

- Urdhri nr. 50, datë 17.2.2019 "Për kriteret dhe procedurën e çmimit 'Ambasadori i Kombit'";

- Vendimi nr. 340, datë 6.6.2018 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve të Këshillit Koordinues të Diasporës";

- Vendim nr. 195, datë 5.4.2019 "Për miratimin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës";

- Vendimi nr. 320, datë 15.5.2019 "Për statusin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës";

- Vendim nr. 469, datë 26.7.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën";

- Urdhri nr. 76, datë 15.4.2019 "Për miratimin e strukturës së Qendrës së Botimeve për Diasporën";

- Vendim nr. 470, datë 26.7.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e qendrave kulturore për diasporën";

- Vendim nr. 24, datë 16.1.2019 "Për themelimin, organizimin dhe funksionimin e Bibliotekës Kombëtare dhe Qendrës së Leximit";

- Urdhër i përbashkët nr. 682, datë 15.10.2018 "Për krijimin e një grupi pune për hartimin e projektakteve nënligjore për regjistrin shtetëror të mësuesve të Diasporës dhe certifikatës së nxënësve në Diasporë";

- Vendim nr. 443, datë 26.6.2019 "Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në Diasporë";

- Vendim nr. 492, datë 10.7.2019 "Për miratimin e çmimeve dhe kategorive që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën për vitin shkollor 2019–2020";

- Vendim nr. 104, datë 28.2.2019 "Për përcaktimin e kritereve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës nxënësve jashtë vendit";

- Urdhri nr. 180, datë 26.12.2018 "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e platformës së programeve të emisioneve të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe kulturën shqiptare dhe identitetin kombëtar";

- Urdhri nr. 181, datë 26.12.2018 "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për organizimin e punës për të bërë funksional pavijonin e Diasporës, në Muzeun Historik Kombëtar";

- Ligji nr. 115, datë 18.12.2017 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës";

- Vendim nr. 114, datë 23.2.2018 "Për përcaktimin e rregullave për emërimin, shkarkimin dhe shpërblimin e kryetarit dhe të anëtarëve të këshillit drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës";

- Ligji nr. 32, datë 7.6.2018 "Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës";

- Vendim nr. 594, datë 9.10.2018 "Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës";

- Vendim nr. 67, datë 13.2.2019 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të hollësishme për administrimin e llogarive, krijimin dhe përdorimin e të ardhurave, të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës";

- Vendim nr. 611, datë 17.10.2018 "Për financimin e projektit 'Diaspora për zhvillim' dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës";

- Vendim nr. 321, datë 15.5.2019 "Për financimin e projektit 'Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë' dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës";

- Urdhri nr. 2, datë 25.10.2018 "Për shpalljen e vende të lira të punës në Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe ngritjen e komisionit përgjegjës për rekrutimin";

- Vendimi nr. 637, datë 26.10.2018 "Për dhënien në përdorim, pa shpërblim, nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare te Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën, të vilave nr. 5, nr. 6 dhe të palestrës të bllokut të vilave gjermane";

- Urdhër nr. 96, datë 16.7.2018 "Për ngritjen e grupit të punës për organizimin e Samitit të Diasporës";

- Vendim nr. 11, datë 9.1.2019 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2019 për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare";

- Rezolutë datë 23.7.2018 "Për reformën e politikës shtetërore për Diasporën";

- Ligj nr. 38 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 129, datë 11.5.2009 'Për gjendjen civile', të ndryshuar, nr i dekretit nr. 10916, datë 19.10.2018";

- Vendimi nr. 690, datë 14.11.2018 "Për prodhimin, transmetimin dhe financimin e emisioneve të posaçme televizive, arsimore dhe kulturore, të dedikuara për Diasporën";

- Vendimi nr. 691, datë 21.11.2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 'Për vetëqeverisjen vendore'";

- Ligj nr. 38, datë 20.6.2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

**5. Buxheti tregues dhe plani për mobilizimin e burimeve**

**5.1 Buxheti**

Buxheti total i Programit do të përcaktohet përmes një procesi më të gjerë konsultimi ndërinstitucional, ku në thelb do të vihet kontributi financiar nga donatorët.

MSHD-ja do të japë kontribute në natyrë për Programin me kostot e stafit dhe organizimin e një sërë mbledhjesh të tryezave të rrumbullakëta për të prezantuar dhe diskutuar publikisht draftin e strategjisë së re për Diasporën, si dhe me anë të kontributit për nismat e ndërmarra në kuadër të kësaj strategjie.

Për më tepër, MSHD-ja do të organizojë mbledhje të pikave të kontaktit të Diasporës dhe seminare për ndërtimin e aftësive teknike, duke ofruar ambientet për mbledhjet dhe pajisjet për përkthim simultan.

**5.1.1 Përmbledhja e buxhetit tregues**

Tabela më poshtë shërben për të paraqitur kornizat treguese të planifikimit për zbatimin e programit. Buxheti i përgjithshëm i parashikuar është akoma për t'u përcaktuar, një përqindje e të cilit është mobilizuar tashmë në kontekstin e projekteve në vazhdim. Kjo krijon një boshllëk financiar, i cili përfshin fonde për monitorimin dhe vlerësimin e përbërësve, si dhe për koordinimin e programit (përfshirë mbledhjen e fondeve, mbledhjet e komitetit dhe komunikimi).

| | **Burimet e nevojshme (euro)** | **Fondet e mobilizuara (euro)** | **Burimet për t'u mobilizuar (euro)** |
|---|---|---|---|
| Komponenti I. Qeverisja e përgjegjshme dhe mbështetja me anë të politikave reaguese | | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Komponenti II. Edukimi dhe hulumtimi për një mjedis të qëndrueshëm | | | |
| Komponenti III. Sipërmarrja dhe investimet e përbashkëta për një rritje gjithëpërfshirëse | | | |
| Njësia e Menaxhimit të Programit | | | |
| M & E | | | |
| Totali | | | |

Programi do të vendosë disa masa për të arritur efektivitetin e kostos. Në lidhje me prokurimet, nënkontraktimi i shërbimeve do të bazohet në një proces transparent dhe konkurrues, dhe në parimin "vlera më e mirë e parasë" Programi do të kërkojë të arrijë ekonominë e shkallës për investimet duke kombinuar, aty kur është e mundur, burimet financiare/instrumentet e financimit me ndërhyrje të tjera të vazhdueshme në lokalitetet e synuara, ose të shpërndajë fonde publike të niveleve më të larta qeverisëse.

Për më tepër, e gjithë mbështetja për trajnimin dhe zhvillimin e kapaciteteve do të ofrohet nga grupimi i qeverive vendore partnere, në mënyrë që të sigurohet ekonomia e shkallës. Programi do të kërkojë të shfrytëzojë kontributin në natyrë nga partnerët vendorë në formën e vendit pritës, mikpritjes dhe kostove të transportit për ngjarjet dhe trajnimin. Për efikasitetin e mëtejshëm të kostos, Programi do të përdorë programet ekzistuese përkatëse të trajnimit, duke zvogëluar kështu koston për hartimin e programit të trajnimit.

**5.2 Plani i Mobilizimit të Burimeve**

Mobilizimi i burimeve për zbatimin e Programit të Diasporës do të bëhet në bashkëpunim me ministrin e Shtetit për Diasporën në emër të Qeverisë së Shqipërisë dhe donatorëve dhe partnerëve të tjerë zbatues/mbështetës. Bashkëpunimi me donatorë dy dhe shumëpalësh, institucionet financiare ndërkombëtar për zhvillim, organizatat ndërkombëtare dhe sektori privat do të jenë thelbësore për të lehtësuar kontributin në përpjekjet e zhvillimit kombëtar të Shqipërisë, veçanërisht për ato që kanë të bëjnë me bashkëpunimin gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm me Diasporën shqiptare. Objektivat, sikurse është rënë dakord me donatorët, mund të arrihen vetëm nëse shfrytëzohen fonde të mjaftueshme për zbatimin e projekteve të mbështetjes teknike, të cilat përbëjnë bërthamën e këtij programi. Qëllimi i programit kërkon planifikimin e duhur dhe të mirë menduar të Strategjisë për Mobilizimin e Burimeve dhe zbatohet së bashku nga SMD-ja dhe partnerët.

Do të bëhen përpjekje për të siguruar fonde për të gjithë komponentët e programit për të siguruar vazhdimësinë dhe për të rritur efektet grumbulluese. Kur kjo nuk është e mundur, fishat individuale të projektit do të propozohen për financim nga donatorët.

Përpjekjet do të përqendrohen në burime financiare dypalëshe, shumëpalëshe dhe jotradicionale përfshirë këtu financimin privat. Në të njëjtën kohë, është gjithashtu e nevojshme që Qeveria e Shqipërisë të alokojë burime të brendshme nga kontribute monetare dhe/ose në natyrë. Kontributet e Qeverisë do të rrisin përkatësinë e rezultateve dhe do të sigurojnë angazhimin ndaj projekteve të zyrtarizuara përmes. Burimet financiare jotradicionale do të angazhohen kryesisht përmes donatorëve në vazhdim dhe sektorit privat, dhe kërkohet hulumtim i mëtejshëm për të identifikuar partnerët specifikë në këto fusha. Mjeti kryesor i mobilizimit të burimeve do të jetë përdorimi i partneriteteve të mundshme me palë të ndryshme të interesit për të arritur ndikim e shkallës për të mirën e Shqipërisë dhe njerëzve të saj. Mobilizimi dhe bashkimi i një sërë burimesh, rrjetesh, njohja dhe kontaktet me partner të ndryshëm mund të sjellë ndryshimin e nevojshëm transformues të ekonomisë lokale dhe forcimin e rezultateve të ndihmës teknike të IOM-it brenda kuadrit të Programit të Angazhimit të Diasporës. Për mobilizim të suksesshëm të burimeve, Qeveria Shqiptare do të ndërmarrë veprime të përbashkëta për të mobilizuar burimet bazuar në komunikimin e ngushtë me donatorët dhe zhvillimin e projekt-propozimeve në përputhje me përparësitë e programit të Diasporës.

Plani paraprak për mobilizimin e burimeve është menduar të jetë fleksibël dhe do të rishikohet dhe përshtatet në mënyrë të vazhdueshme për t'u siguruar se mbulon në mënyrë efikase prioritetet strategjike të Qeverisë së Shqipërisë, të donatorëve dhe të partnerëve të tjerë. Plani i zhvilluar plotësisht për mobilizimin e burimeve do të finalizohet në fazën fillestare të programit. Ai do të hartohet nga një grup pune i përbërë nga stafi i kabinetit të MSHD-së, ekspertizë nga IOM-i, Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Zyrën e Kryeministrit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

SHTOJCË I
LISTA E PROJEKTKONCEPTEVE TË HARMONIZUARA ME NËNPROGRAMET

Të tre komponentët e përmendur në pjesën 2 në Dokumentin e Programit janë dhënë në hollësi të mëtejshme në fishat e projekti, të cilat janë listuar më poshtë:

**Komponenti I. Qeverisja e përgjegjshme dhe mbështetja me anë të politikave reaguese**

1. Mbështetje për qeverisjen institucionale në nivel qendror dhe vendor për të dhënë rezultate më të mira në angazhimin e Diasporës në zhvillimin vendor.
2. Zhvillimi i kapacitetit për administratën bashkiake në përdorimin e TIK-ut për dialog dhe angazhim të Diasporës në zhvillimin vendor.
3. Mbështetje për gratë emigrante, lidhur me ndërgjegjësimin e të drejtave individuale, mbrojtjen efektive dhe për lirinë e organizimit.
4. Mbështetja e të rinjve në Diasporë për pjesëmarrjen në vendimmarrjen vendore, shkëmbimin e mësimit ndërkulturor përmes arsimit global, rrjetëzimit dhe dialogut.
5. "Shqipëria" Shtëpia e Talenteve: mbështetje për ekselencën në kërkimet shkencore dhe mundësi arsimimi e avancuar për studentët shqiptarë që ndjekin programet e studimit në universitete të huaja në Evropë, SHBA dhe Kanada.
6. Masat parandaluese vendore kundër migrimit të paligjshëm të të miturve të pashoqëruar.

**Komponenti II. Edukimi dhe hulumtimi për një mjedis të qëndrueshëm**

7. Promovimi i zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve në komunitetet shqiptare jashtë vendit përmes rritjes së ndërgjegjësimit për CRC-në dhe mësimin e gjuhës amtare.
8. Mbështetja e zhvillimit të aftësive profesionale për të rinjtë nga zonat rurale në Shqipëri përmes trajnimeve në shoqëri shqiptare jashtë vendit.
9. Përmirësimi i aftësive mbështetëse në mësimdhënien e historisë shqiptare dhe kulturës, në të gjithë botën.

**Komponenti III. Sipërmarrja dhe investimet e përbashkëta për një rritje gjithëpërfshirëse**

10. Mbështetja e bashkëpunimit shkencor dhe analizave të politikave të bazuara në studime me studiues shqiptarë me kualifikim të lartë jashtë vendit për mbrojtjen e mjedisit dhe uljen e rrezikut nga fatkeqësitë.
11. Promovimi i angazhimit aktiv të Diasporës në planifikimin e zhvillimit lokal dhe menaxhimin territorial me një fokus të veçantë në mbrojtjen e mjedisit dhe uljen e rreziqeve nga katastrofat.
12. Promovimi i punës vullnetare të të rinjve në parqet kombëtare dhe zonat e mbrojtura në Shqipëri për të diplomuarit e rinj që jetojnë jashtë vendit.
13. Subvencion për kthimin e shtetasve shqiptarë.
14. Shqipëria "Një shtëpi e sigurt" – në ndihmë të emigrantëve me origjinë shqiptare mbi moshën 60 vjeç.
15. Ditët e Shqipërisë: një kontribut në mbrojtjen dhe promovimin e shumëllojshmërisë së shprehjeve kulturore.
16. Lehtësimi i shkëmbimit të njohurive dhe transferimit të teknologjisë për iniciativa biznesesh novatore.

17. Përmirësimi i rekrutimit dhe mbajtjes së profesionistëve të shëndetit në Shqipëri përmes angazhimit të Diasporës.

18. Lehtësimi i bashkëpunimit kërkimor shkencor midis Diasporës shqiptare dhe komunitetit të kërkimit shkencor në Shqipëri.

19. Lehtësimi i zhvillimit të biznesit në Shqipëri për emigrantët shqiptarë të kthyer dhe me kualifikim të lartë.

**Komponenti I. Qeverisja e përgjegjshme dhe mbështetja me anë të politikave reaguese**

#1. Mbështetje për qeverisjen institucionale në nivel qendror dhe vendor për të dhënë rezultate më të mira në angazhimin e Diasporës në zhvillimin vendor.

| | |
|---|---|
| **Titulli i projektit:** | Mbështetje për qeverisjen institucionale në nivel qendror dhe vendor për të dhënë rezultate më të mira në angazhimin e Diasporës në zhvillimin vendor. |
| **Masat strategjike të Diasporës:** | 1, 7, 10, 14, 33, 38, 43, 57 |
| **Vendndodhjet e projektit:** | Faza fillestare/pilot: 3 bashki pilot, Shkodër, Tiranë, Korçë<br>Faza e zbatimit: të gjitha bashkitë e identifikuara në Shqipëri sipas objektivave të projektit. |
| **Kohëzgjatja totale e projektit (muaj):** | - Faza përgatitore: 3 muaj;<br>- Faza e zbatimit pilot; 24+ muaj;<br>- Rishikimi dhe riaplikimi: në vazhdim. |
| **Kontributi që iu kërkohet donatorëve (shuma):** | 480,000 euro |
| **Kontributi që iu kërkohet donatorëve, i shprehur si përqindje e kostos totale të pranueshme të projektit (tregues):** | 100% |
| **Buxheti total tregues:** | 480,000 euro |
| **Objektivat e projektit:** | Objektivat e përgjithshëm:<br>- Mundësimi i asistencës teknike dhe zhvillimit të duhur të kapaciteteve të qeverisjes institucionale në nivel qendror dhe vendor me qëllim ofrimin e rezultateve dhe shërbimeve në përgjigje të synimeve të politikave për angazhimin e Diasporës në zhvillimin vendor.<br>- Përdorimi i vlerave dhe arritjeve të Diasporës shqiptare për krijimin e partneriteteve të qëndrueshme me qeverisjen vendore në vendin e origjinës për të lidhur dhe transferuar njohuritë dhe për të rritur bashkëpunimin në sektorë të ndryshëm të zhvillimit social dhe ekonomik në komunitetet në vendin e origjinës dhe në vendin pritës.<br><br>Objektivat specifikë:<br>- Krijimi dhe vënia në funksion e mekanizmave efektivë institucional për t'i shërbyer dhe për të angazhuar Diasporën shqiptare në nivel vendor në komunitetet e vendit të origjinës;<br>- Mundësimi i një sërë shërbimesh lehtësuese për t'iu përgjigjur nevojave të Diasporës lidhur me shërbimet territoriale dhe institucionale, si dhe vlerat kulturore;<br>- Krijimi i lidhjeve dinamike të institucioneve vendore me grupet dhe organizatat e Diasporës shqiptare me qëllim njohjen dhe partneritetin e ndërsjellë, promovimin e kontributeve, vlerave historike dhe tradicionale, si dhe inkurajimin e investimeve në vendin e origjinës. |
| | - Lidhja, këshillimi dhe përputhja me potencialin teknik dhe/ose financiar të Diasporës me nevojat dhe mundësitë vendore për rritje të qëndrueshme dhe krijimin e vendeve të punës;<br>- Promovimi i binjakëzimit, partneritetit dhe bashkëpunimit midis bashkive në Shqipëri dhe në vendin pritës. |

| | |
|---|---|
| **Grupet e synuara:** | Stafi i bashkive në Tiranë, Shkodër, Korçë (faza pilot) Administrata bashkiake lokale;<br>Zyrat e gjendjes civile në të gjitha bashkitë e Shqipërisë; Regjistri i biznesit/zyrat e taksave në të gjitha bashkitë e Shqipërisë; zyrat/agjencitë e turizmit në të gjitha bashkitë e Shqipërisë;<br>Shoqatat lokale profesionale dhe grupet komunitare në të gjithë vendin. |
| **Përfituesit përfundimtarë:** | Komuniteti lokal<br>Komuniteti shqiptar i Diasporës<br>Bashkitë si institucion |
| **Partnerët [financimi; zbatimi]:** | Komisioni Evropian, Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, IOM, Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme; Ministria e Kulturës, Këshilli i Evropës (CoE), Rrjeti i shoqatave të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS), Dhoma e Biznesit të Diasporës, Shoqata Shqiptare e Autonomisë Lokale, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë. |
